



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR ECURINË E PROCESIT ZGJEDHOR TË ZGJEDHJEVE TË 21 QERSHORIT 2015

Monitorimi i zgjedhjeve dhe hartimi i këtij raporti u financuan nga Ambasada e SHBA, me fonde të Departamentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe organizata suedeze Civil Rights Defenders, me fonde të Mbretërisë Suedeze.



Kingdom of Sweden



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

PASQYRA E LËNDËS

- *Shkurtimi i emrave dhe fjalëve*
- I. Hyrje
- II. Përmbledhje ekzekutive
- III. Masat për përgatitjen e zgjedhjeve dhe fushata zgjedhore
- IV. Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë dhe listat përfundimtare të zgjedhësve
- V. Informimi dhe sensibilizimi i zgjedhësve
- VI. Administrimi i zgjedhjeve
 - a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
 - b) Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor
 - c) Komisionet e Qendrave të votimit
- VII. Regjistrimi i kandidatëve
- VIII. Procesi i votimit
 - a) Baza materiale
 - b) Respektimi i orarit të hapjes së QV-ve
 - c) Situata e rregullit në QV dhe ligjshmërisë gjatë procesit të votimit
 - d) Ndërprerje të procesit të votimit
 - e) Votimi familjar
 - f) Votimi i personave me aftësi të kufizuara
 - g) Votimi në institucione të posaçme
 - h) Vëzhguesit e procesit dhe vërejtjet me shkrim të tyre
 - i) Përfundimi i procesit të votimit
- IX. Procesi i numërimit të votave
 - a. Shoqërimi i materialeve dhe i kutive të votave
 - b. Ngritja e komisioneve të numërimit të votave
 - c. Zbatimi i orarit për fillimin e numërimit
 - d. Ecuria e procesit të numërimit të votave
- X. Vëzhguesit e procesit dhe vërejtjet me shkrim të tyre
- XI. Performanca e Gjykatave, Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit
 - a. Gjykatat
 - b. Policia e shtetit
 - c. Prokuroria
- XII. Performanca e subjekteve zgjedhore
- XIII. Performanca e zgjedhësve
- XIV. Konkluzione dhe rekomandime

• SHKURTIMI I FJALËVE DHE EMRAVE

- KShH - Komiteti Shqiptar i Helsinkit
- KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- KZ - Kodi Zgjedhor
- KZAZ - Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor
- KQV - Komisionet të Qendrave të Votimit
- QV - Qendrat e Votimit
- IEVP - Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale
- IP - Institucione të Paraburgimit
- GNV - Grupet e Numërimit të Votave



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

I. Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse i themeluar më 16 Dhjetor të vitit 1990, regjistruar më pas, me cilësinë e një shoqate, në mbështetje të ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”.

Misioni KShH është të kontribuojë për mbrojtjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

Në këtë kuadër KShH ka monitoruar të gjitha proceset zgjedhore të zhvilluara në Shqipëri, që nga viti 1996, duke vlerësuar respektimin e zbatimit të standardeve të Kopenhagenit, të së drejtës kushtetuese për të zgjedhur e për t’u zgjedhur, si dhe ka përgatitur e prezantuar raporte lidhur me gjetjet dhe rekomandime për përmirësimin e situatës në këto drejtime.

Për monitorimin e zgjedhjeve të 21 Qershorit 2015, KShH aktivizoi rreth 90 vëzhgues afatgjatë, 7 korrespondentët e tij në rrethe, si dhe 8 persona të stafit, te gjithë të akredituar, sipas ligjit, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Vëzhguesit u trajnuan, paraprakisht, lidhur me aspektet më të rëndësishme të Kodit Zgjedhor (KZ), si dhe lidhur me metodologjinë e monitorimit, që do të aplikohet për vëzhgimin e këtyre zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor. Në dispozicion të vëzhguesve u vunë materiale instruktive, pyetësorë, gjysëm të strukturuar dhe materiale të tjera të nevojshme për realizimin dhe mbarëvajtjen e vëzhgimit.

Monitorimi i procesit zgjedhor u shtri në të gjitha fazat e tij, duke filluar nga periudha përgatitore, fushata zgjedhore, dita e votimit dhe pjesërisht numërimi i votave. Monitorimi ka mbuluar, gjithashtu, veprimtarinë e një pjese të organeve të administratës zgjedhore, të të gjitha niveleve; veprimtarinë e organeve publike, që janë ngarkuar nga ligji me detyra për përgatitjen e zgjedhjeve; veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, të përfshira në këto zgjedhje; si dhe sjelljen e zgjedhësve. Rëndësi e veçantë iu kushtua sensibilizimit dhe informimit të zgjedhësve, veçanërisht të atyre që votonin për herë të parë, ose që u përkasin grupeve në nevojë, me qëllim nxitjen e tyre për të marrë pjesë në votim dhe ushtrimin e të drejtës së votës, në mënyrë të lirë e të pandikuar. Për sensibilizimin dhe informimin e zgjedhësve u zhvilluan dhe dy forume qytetare, me pjesëmarrjen e kandidatëve për kryetarë bashkie dhe këshillat bashkiake, të cilat u mbajtën në Elbasan e Gjirokastrë.

Ditën e votimit KShH **monitoroi rreth 600 qendra votimi**, në 9 bashkitë kryesore të vendit si, në Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Shkodër, Vlorë, Kukës, Korçë, etj., rreth 40% të KZAZ-ve të vendit dhe 10% të QV-ve. **U vëzhguan, gjithashtu, 8 qendra të numërimit të votave**, të përfshira në KZAZ-të ku u shtri vëzhgimi. .

Në këtë raport jemi ndalur në disa aspekte kryesore, që lidhen me procesin zgjedhor si: shpallja e listave paraprake dhe atyre përfundimtare të zgjedhësve; aksesueshmëria e zgjedhësve mbi këto lista; mundësimi i së drejtës për të kërkuar korigjimin e listave të zgjedhësve; njoftimi i zgjedhësve në banesë lidhur me përfshirjen e tyre në lista dhe qendrën ku duhet të paraqiten për të votuar; zhvillimi i fushatës elektorale dhe informuese për zgjedhësit; mundësimi i komunikimit dhe njohjes së zgjedhësve me kandidatët e përfshirë në lista; funksionimi i KQZ-së, KZAZ-ve dhe Komisioneve të Qendrave të



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Votimit (KQV); trajnimi i anëtarëve të tyre; zhvillimi i procesit të votimit dhe numërimit të votave; plotësimi i detyrave nga organe të ndryshme publike, që ligji u ka përcaktuar kompetenca në këtë drejtim, etj.

Ky raport hartohet, kryesisht, mbi bazën e të dhënave dhe informacioneve të mbledhura nga vëzhguesit e KSHH-së, por në lidhje me disa aspekte kemi përdorur dhe informacione të servitura nga mediat dhe organizata të tjera të shoqërisë civile.

KSHH falenderon të gjithë vëzhguesit dhe korrespondentët e tij, në 9 bashkitë kryesore të vendit, për profesionalizmin, paanshmërinë dhe përkushtimin e tyre. Gjithashtu, falenderojmë Ambasadën e SHBA në Tiranë dhe organizatën suedeze Civil Rights Defenders (nënkontraktor i Mbretërisë Suedeze), që mundësuan veprimtaritë tona gjatë këtij procesi zgjedhor, duke financuar projektet tona.

II. Përmbledhje ekzekutive

Votimi më 21 Qershor 2015 u zhvillua për zgjedhjen e **61 kryetarëve të bashkive dhe 1.595 anëtarë të këshillave bashkiake**, sipas ndarjes së re administrative-territoriale, e cila hyri në fuqi në vitin 2014. **Kuvendi i Shqipërisë, ndonëse me vonesë, bëri plotësimin e anëtarëve të KQZ-së dhe** miratoi disa ndryshime në KZ, të cilat konsistojnë në vendosjen e kriterit të përfaqësimit të barabartë mes gjinive, në listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë, si dhe disa amendime të tjera të karakterit teknik. **Rritja e kuotës gjinore përbën një hap të rëndësishëm, që mundësoi rritjen e grave në masën mbi 49% në këshillat bashkiake të dala nga këto zgjedhje.** Megjithatë **ndryshimet në KZ u kryen me vonesë, pa transparencën dhe përfshirjen e duhur**, veçanërisht të përfaqësuesve të zgjedhësve. Gjithashtu, këto ndryshime nuk përfshinë rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, të bëra në zgjedhjet e mëparshme. Forcat politike të pozitës dhe opozitës nuk gjetën konsensusin midis tyre për të realizuar, në kohë, rishikimin e plotë të KZ. Për pasojë, nëpërmjet ndryshimeve të bëra në ligjin zgjedhor ju deleguan KQZ një sërë kompetencash shtesë, vetëm për procesin zgjedhor të 21 Qershorit 2015 (*shih pikën 3 të nenit 184 të KZ të ndryshuar*). Për administrimin e zgjedhjeve u krijuan **90 KZAZ** dhe u hapën **5.299 QV**. Në këto zgjedhje u regjistruan si subjekte zgjedhore **63 parti politike**, shumica e tyre të përfshira në koalicione dhe vetëm 11 prej tyre garuan të vetme. U regjistruan dhe disa kandidatë të pavarur për kryetarë bashkie. Në listën përfundimtare të zgjedhësve u regjistruan, gjithsej, **3.370.206 zgjedhës** (sipas DPGJC), prej të cilëve votuan **1.613. 019 zgjedhës, ose 47.86 % e tyre.**

Regjistrimi i subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të tyre, si dhe kandidatëve të pavarur, u krye në afatet e parashikuara në KZ, por KQZ dhe Kolegji Zgjedhor morën shumë ankesa lidhur me procesin e kryer nga KZAZ-të për këtë qëllim. U regjistruan **rreth 36.250 kandidatë për anëtarë të këshillave bashkiake dhe 162 kandidatë për kryetarë bashkie**. Grupet politike në Kuvend dhe përfaqësues të organizmave ndërkombëtare, të akredituara në vend, parashtruan çështjen e “dekriminalizimit” të listave të kandidatëve dhe strukturave të pushtetit publik. Megjithatë reagimi mbeti në nivelin e retorikës politike dhe nuk solli përmirësime të legjislacionit, ose veprime konkrete sinjifikative në këtë drejtim. Me ndonjë përjashtim të rrallë, nuk pati ndërhyrje të subjekteve zgjedhore për të mënjanuar kandidatët e dyshuar si të inkriminuar. Organet e drejtësisë nuk dhanë informacion, ose ndihmën e duhur për qartësimin e situatave për kandidatë konkretë dhe nuk sollën fakte në



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

këtë drejtim. Zgjedhësit mbetën të painformuar plotësisht lidhur me emrat e kandidatëve konkretë të dyshuar si të inkriminuar, si dhe për forcat politike që i kishin përfshirë ata në listat e tyre. Proçesi i regjistrimit të kandidatëve dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë u bë objekt kundërshtimi dhe vendim-marrjeje në KQZ, si dhe në Kolegjin Zgjedhor, por këto organe nuk treguan konsekuencë në argumentimin e vendim-marrjes së tyre. Këto organe manifestuan probleme në arsyetimin dhe publikimin në kohë të vendimeve të tyre, gjë që çënoi transparencën ndaj publikut. Legjislacioni zgjedhor duket se ka mangësi lidhur me të drejtën për t'u zgjedhur dhe lejon kandidimin e personave të inkriminuar. Megjithatë tregues domethënës ishte pjesëmarrja e gjerë e partive të vogla politike, me listat e tyre të kandidatëve, si dhe e kandidatëve të pavarur, disa prej të cilëve të votuar në mënyrë evidente nga zgjedhësit. U regjistruan 16 candidate femra për kryetare bashkie, 9 prej të cilave u shpallën fituese.

Fushata zgjedhore filloi shumë më përpara afatit ligjor. KQZ reagoi për këtë, por nuk ndëshkoi subjektet zgjedhore që vazhduan të zhvillojnë fushatë në kundërshtim me ligjin. Në periudhën para zgjedhore situata e sigurisë dhe rendit publik ishte e qetë, por klima politike ishte relativisht e tensionuar, për shkak të akuzave reciproke të përfaqësuesve të koalicioneve, të krijuara në kuadër të zgjedhjeve, të cilët në ndonjë rast tejkaluan rregullat e etikës shoqërore e politike. Partitë e mëdha politike zhvilluan takime intensive elektorale me zgjedhësit, të shoqëruara me shpenzime të mëdha, veçanërisht kjo u vu re për koalicionin qeverisës. **Janë ngritur pretendime lidhur me mungesën e transparencës së subjekteve zgjedhore lidhur me financimin e fushatave të tyre,** veçanërisht për pranimin e financimeve nga individë privatë dhe biznese, duke aluduar për favore të premtuara nga kandidatët, nëse ata do të dilnin fitues. Kjo është një çështje që duhet verifikuar me këmbëngulje dhe kujdes nga organet përkatëse, sepse është çështje që lidhet drejtpërsëdrejti me realizimin e zgjedhjeve të lira e të drejta.

Kandidatët për kryetarë bashkie dolën para publikut me premtime konkrete, por kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiake nuk u prezantuan dhe nuk komunikuan me zgjedhësit, me përjashtime të pakta. Për pasojë, nuk u bë e qartë përfaqësimi në lista i banorëve të zonave rurale, që iu bashkohen bashkive të krijuara pas reformës së pushtetit vendor, si dhe nuk u bënë të njohura për zgjedhësit meritat dhe aftësitë e kandidatëve për këshilltarë. Pati përsëri raste të përdorimit të punonjësve të administratës dhe mjeteve publike në fushatën zgjedhore, ndonëse në një numër më të kufizuar se në zgjedhjet e kaluara.

Rezulton se në këto zgjedhje, **listat e zgjedhësve ishin të një cilësie më të mirë se më parë.** Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë, në përgjithësi, u afishuan çdo muaj. Megjithatë, në disa raste, ato u afishuan vetëm dy muajt e fundit dhe në mënyrë të tillë që nuk mundësonte aksesin e plotë të zgjedhësve. Rezulton se kërkesat për ndryshimin e përbërësve zgjedhorë në listat paraprake kanë qënë relativisht të pakta. Në listat përfundimtare të zgjedhësve u **përfshinë 3.370.206** shtetas me të drejtë vote, nga të cilët kanë **votuar 1.613.019 zgjedhës, ose 47.86 %** e tyre.¹ Në listat e zgjedhësve janë të përfshirë dhe rreth 1 milion shtetas, të cilët janë në emigracion, jashtë vendit. Rreth 7000 shtetas shqiptarë kanë hyrë për të votuar nga pikat e kalimit kufitar, në jug të vendit. **Është e nevojshme të përmirësohet legjislacioni në këtë drejtim, me qëllim që të mundësohet realisht e drejta e ushtrimit të votës për zgjedhësit që jetojnë jashtë vendit, si dhe për të saktësuar dhe unifikuar legjislacionin në lidhje me përcaktimin e vendbanimit të shtetasve, gjë që përbën**

¹ Të dhënat janë marrë nga faqja zyrtare e KQZ në dt. 26.06.2015



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

elementin kryesor për përfshirjen e shtetasve në listat zgjedhore. Njoftimi me shkrim i zgjedhësve në banesë, lidhur me përfshirjen në lista dhe qendrën përkatëse të votimit, si dhe sensibilizimi i zgjedhësve la për të dëshëruar.

KQZ ka përballuar mirë veprimtarinë e administrimit të procesit zgjedhor, duke qenë më efikase dhe operative, në kushtet kur legjislacioni zgjedhor nuk u përmirësua në të gjitha drejtimit ku ishin evidentuar nevojat. Patë raste të mungesës së konsequencës në arsyetimin e vendim-marrjes nga ky organ. Është vërejtur se ka patur ndryshime apo zëvendësime të anëtarëve të KZAZ para dhe pas procesit të votimit. Kjo gjë nuk ndihmoi në trajnimin efektiv të tyre dhe mirëfeksionimin e këtyre organeve. Performanca e administratës zgjedhore të nivelit të dytë, e të tretë (**KZAZ dhe KQV**) **tregoi kapacitete jo tepër të mira për menaxhimin e zgjedhjeve.** Duket se cilësia e trajnimit dhe ndryshimi i shpeshhtë i komisionerëve janë faktorë që ndikuan në mungesën e aftësive dhe njohurive mbi rregullat e administrimit të zgjedhjeve.

Dita e zgjedhjeve ka qenë në përgjithësi e qetë dhe zgjedhësit kanë votuar të lirë dhe pa presion. Ka patur pretendime, nga të gjitha palët, në lidhje me blerjen e votës ose presionin e ushtruar mbi zgjedhësit, por raste të tilla nuk u denoncuan pranë organeve të ndjekjes penale, me përjashtim të rasteve të akuzave për shtimin abuziv të zgjedhësve në Durrës, Kavajë dhe Vorë, të cilat janë shqyrtuar, ose po shqyrtohen nga organet kompetente.

Proçesi i votimit është zhvilluar, përgjithësisht, në përputhje me ligjin, megjithatë KQZ nuk garantoj që të gjitha materialet zgjedhore të përgatiteshin në sasinë e cilësinë e duhur dhe nuk realizoi shpërndarjen e tyre brenda afateve të parashikuara në KZ. Në më shumë se 50% të QV, të monitoruara nga KShH, proçesi i votimit ka filluar me vonesë, duke nisur nga 15- 40 minuta dhe në pak raste edhe më vonë. Në disa KQV të pakta organizimi i mjedisit të Qendrave të Votimit u bë në mënyrë të gabuar dhe dhoma e fshehtësisë nuk garantoj fshehtësinë e votës, por në shumicën e rasteve, më pas komisionet pranuan vërejtjet e referuara nga vëzhguesit dhe riparuan situatën e konstatuar në këtë drejtim. Janë vërejtur simbole të subjekteve politike në afërsi të QV, në kundërshtim me ligjin, të cilat duhet të ishin larguar përpara fillimit të votimit. Ka patur rënie të votimit familjar në krahasim me zgjedhjet e mëparshme, por jo gjithmonë u morën masat e duhura për të mundësuar, sipas ligjit, ushtrimin e votës nga zgjedhës me aftësi të kufizuar. Në disa institucione të posaçme si spitalet rajonale nuk janë ngritur QV-të, megjithëse plotësoheshin kushtet ligjore, lidhur me numrin e pacientëve dhe afatin e qëndrimit të tyre në institucion. Si rrjedhim zgjedhësit me probleme shëndetësore nuk patën gjithmonë mundësi për të votuar.

KQZ akreditoi një numër të madh vëzhguesish vendas e të huaj. KQV-të janë treguar më të hapur ndaj vërejtjeve të vëzhguesve, vendas e të huaj, lidhur me shkeljet e konstatuara gjatë votimit, të cilat vetëm pjesërisht janë protokolluar sipas ligjit.

Përfundimi i procesit zgjedhor, përgjithësisht, është kryer në orën dhe mënyrën e parashikuar në ligj. Proçesi i shoqërimit të kutive me dokumentacionin e QV-ve dhe fillimi i numërimit të votave, përgjithësisht, u kryen duke respektuar proçedurat e parashikuara në KZ, por në disa KZAZ, numërimi nuk filloi në kohën e parashikuar në ligj, për shkak të mosëmërimit të numëruesve, si dhe për shkak të mos trajnimit të tyre në kohë.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Në përgjithësi, konstatohet se procesi i numërimit ka vazhduar tej afatit ligjor. Ky proces është ndërprerë, herë pas here, pasi anëtarët e GNV kanë kërkuar kohë pushimi, ose për arsye të tjera. Pranimi publikisht i rezultatit dhe urimi i kandidatëve kundërshtarë për fitoren në Tiranë, Shkodër, Fier etj., tregoi emancipim dhe rritje të kulturës demokratike të këtyre kandidatëve.

Policia e Shtetit ka kryer detyrën me profesionalizëm dhe paanshmëri. Ajo ka qenë në gatishmëri për ruajtjen e rregullit dhe rendit, duke mbikqyrur QV dhe ecurinë e procesit zgjedhor, por duke ruajtur distancën e duhur prej tyre. Megjithatë mbetet vërejtja se, për shkak të mungesave të parashikimeve ligjore dhe mënyrës së organizimit të punës së organeve të policisë, **nuk u mundësua ushtrimi i të drejtës së votës nga një numër i lartë i punonjësve të policisë së shtetit.**

Mediat pasqyruan gjerë procesin zgjedhor, por pati dhe shkelje të kohës së vënë në dispozicion për subjektet zgjedhore të vogla ose kandidatët e pavarur. Mbeti problem i pazgjidhur për mediat, pasqyrimi i fushatave të partive të mëdha politike nëpërmjet materialeve të përgatitura nga vetë subjektet zgjedhore. Disa media investigative u përpoqën të hedhin dritë mbi kandidatët e inkriminuar dhe i dhanë publikut të vetmin informacion të pakët në këtë drejtim.

Subjektet zgjedhore dhanë kontributin e tyre në ruajtjen e qetësisë dhe zhvillimin e zgjedhjeve të qeta. Liderët e partive kryesore politike kanë bërë thirrje që votuesit të merrnin pjesë në votim, si dhe kanë shpjeguar rëndësinë e këtyre zgjedhjeve, por në disa raste, përfaqësuesit e tyre trasmetuan tension nëpërmjet gjuhës së përdorur dhe duke manifestuar ndonjë sjellje jo korrekte. Subjektet zgjedhore politike janë përgjegjësit kryesorë për mospastrimin e listave të kandidatëve të tyre nga personat e inkriminuar. Përgjithësisht heshtja zgjedhore është respektuar, por subjektet zgjedhore mobilizuan dhe dërguar pranë QV-ve vëzhgues dhe militantë të shumtë, që krijuan konfuzion dhe shqetësim tek zgjedhësit.

Sjellja e zgjedhësve ishte më e mira, midis subjekteve të përfshirë në këto zgjedhje. Ata votuan të qetë dhe përgjithësisht respektuan rregullat e procesit. Ata u treguan më të gatshëm për të deklaruar publikisht presionin dhe tentativat për blerjen e votës, por nuk denoncuan këto veprime pranë organeve kompetente të drejtësisë.

III. Masat për përgatitjen e zgjedhjeve dhe fushata zgjedhore

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 8844, datë 15.12.2014, caktoi datën 21 Qershor 2015 si ditën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor. **Fushata zgjedhore filloi shumë ditë përpara afatit ligjor, të përcaktuar nga n. 77 i KZ.** KQZ reagoi për këtë çështje, ndonëse me vonesë, por nuk tregoi konsekuencë për të ndëshkuar subjektet zgjedhore që vazhduan të zhvillojnë fushatë në kundërshtim me ligjin.

Në periudhën para zgjedhore, si dhe gjatë zhvillimit të fushatave për prezantimin e kandidatëve dhe programeve të tyre, situata e sigurisë dhe rendit në vend ishte përgjithësisht e qetë, por klima politike ishte relativisht e tensionuar, për shkak të akuzave reciproke të përfaqësuesve të pozitës e opozitës në Kuvend dhe mungesës së bashkëpunimit midis tyre. Në ndonjë rast, përfaqësuesit e subjekteve politike tejkaluan rregullat e etikës



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

shoqërore e politike, gjë që reflektonte negativisht në publik. Ndikim negativ në këtë drejtim shkaktoi dhe mungesa e konsensusit për të ndërmarrë nismat e nevojshme legislative e organizative lidhur me procesin zgjedhor. Nuk munguan dhe incidente sporadike pa pasoja të rënda, si në Durrës, Lezhë, Peqin, Paskuqan, etj. KShH ka reaguar publikisht për ngjarjen e Durrësit, të datës 2 Maj 2015, ku militantë të forcave kundërshtare politike ndërhyrën gjatë mitingut të organizuar nga kandidatja për kryetare bashkie e PD.

Qetësia dhe siguria publike ndikuan pozitivisht për ecurinë e fushatës zgjedhore dhe për marrjen e masave për përgatitjen e zgjedhjeve, si dhe mundësoi atmosferën e duhur për ditën e votimit.

Proçesi i regjistrimit të kandidatëve dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë u bë objekt kundërshtimi dhe vendim-marrjeje në KQZ, si dhe në Kolegjin Zgjedhor, por këto organe nuk treguan konsequencë në argumentimin e vendim-marrjes së tyre. KQZ manifestoi, në disa raste, probleme në zgjidhjen, arsyetimin dhe publikimin në kohë të vendimeve të tij, gjë që çënoi transparencën ndaj publikut. Disa vendime u dhanë në mungesë të bazës ligjore, me arsyetimin se ai organ duhet t'u jepte zgjidhje të gjitha problemeve që manifestoheshin gjatë procesit zgjedhor. **Legjislacioni zgjedhor duket se nuk bën rregullim të barabartë për kandidatët e pavarur dhe ata të përfshirë në listat e subjekteve zgjedhore, lidhur me të drejtën kushtetuese për t'u zgjedhur.** Për pasojë kandidatët e pavarur u përballën me vështirësi më të mëdha se kandidatët e listave shumemërore të subjekteve politike, për të plotësuar kushtet ligjore të regjistrimit si kandidatë. Gjithashtu legjislacioni nuk parashikon që kandidatët e pavarur për kryetarë bashkie të kenë të drejtë të paraqesin listën e tyre për këshilltarë bashkiakë. Në këtë drejtim u konstatua se, në ndonjë rast, në bashkitë e mëdha, ku ishin ngritur disa KZAZ dhe për pasojë regjistrimi i kandidatëve të tyre bëhej nga KQZ, KZAZ-të përkatëse nuk kishin asnjë informacion rreth kandidatëve të regjistruar. Kjo u konstatua në KZAZ-të e Korçës.

Megjithatë tregues domethënës ishte pjesëmarrja e gjerë e partive të vogla politike, me listat e tyre të kandidatëve në këto zgjedhje, si dhe e kandidatëve të pavarur, disa prej të cilëve të votuar në mënyrë evidente nga zgjedhësit. U regjistruan 16 kandidatë femra për kryetare bashkie, 9 prej të cilave rezultuan fituese, si dhe u respektua kriteri gjinor në listat e kandidatëve për këshilltarë. Kjo rriti ndjeshëm pjesëmarrjen e grave në organet e pushtetit vendor.

Partitë e mëdha politike, të përfaqësuara kryesisht nga kryetarët e tyre, zhvilluan takime intensive elektorale në zona të ndryshme të vendit. Fushatat e tyre u shoqëruan me shpenzime të mëdha, veçanërisht kjo ra në sy për disa nga forcat politike të koalicionit qeverisës. Janë ngritur pretendime në lidhje me mungesën e transparencës së subjekteve zgjedhore lidhur me financimin e fushatës, veçanërisht për fondet e dhuruara nga individë privatë dhe biznese, duke aluduar për favore të premtuara nga kandidatët, nëse ata do të dilnin fitues. Edhe pse KShH nuk mundi të gjejë prova konkrete në këtë drejtim, ngremë me forcë shqetësimin se kjo është një çështje që duhet verifikuar me kujdes nga organet përkatëse. Qartësimi i situatës së financimeve që përfitojnë subjektet zgjedhore për fushatat e tyre do ta bënte procesin zgjedhor më të drejtë dhe më të besueshëm, si dhe do të parandalonte çdo ndërhyrje apo influencë të paligjshme, mbi organet e zgjedhura.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Kandidatët për kryetarë bashkie bënë përpjekje për t'u paraqitur përpara zgjedhësve në fushatë me programe konkrete dhe informuan publikun rreth cilësive dhe arritjeve personale në jetë, por prezantimi i kandidatëve për këshilltarë nuk u bë në shumicën e rasteve dhe publiku nuk i njohu ata, nuk erdhi në dijeni të vendbanimit të tyre dhe cilësive që i karakterizonin. Drejtuesit e subjekteve zgjedhore dolën në fushatë, kryesisht me programe partiake dhe ndëruan fushatat e tyre duke u bazuar në akuza denigruese ndaj forcave politike kundërshtarë.

Legjislacioni zgjedhor ka rregulluar mënyrën e ndarjes së kohës mediatike për kandidatët e subjekteve të ndryshme zgjedhore. Nisur nga raportet e Bordit të Monitorimit të Medias, KQZ ka gjobitur disa media kombëtare e lokale, si dhe ka vendosur kompensimin nga ana e tyre të kohës së transmetimit në funksion të balancës politike.

Pati raste më të pakta në raport me zgjedhjet e kaluara, të përdorimit të punonjësve të administratës dhe mjeteve publike në fushatën zgjedhore. Megjithatë, rastet e përdorimit të administratës publike, të nxënësve të shkollave dhe të punonjësve të shërbimeve publike për fushatë, gjë për të cilën pati informacion nga mediat dhe disa ofj që investiguan në terren, duhet të marrin fund dhe ndaj fenomeneve të tilla duhet nxjerrë përgjegjësia e personave që i urdherojnë ato, në përputhje me ligjin.

Mangësitë e mësipërme u reflektuan dhe në programet e mediave, sepse ato i pasqyruan fushatat, kryesisht nëpërmjet materialeve të përgatitura nga vetë subjektet zgjedhore dhe për pasojë zgjedhësit, veçanërisht ata të moshës së re, por jo vetëm, kanë parashtruar shqetësimin se nuk morrën informacionin e duhur rreth kandidatëve.

IV. Listat paraprake të zgjedhësve (ekstraktet e përbërësve zgjedhorë) dhe listat përfundimtare të zgjedhësve

Në listat përfundimtare të zgjedhësve për Zgjedhjet Vendore të dt. 21 qershor 2015 figurojnë të regjistruar **3.370.206** shtetas shqiptarë me të drejtë vote, nga të cilët **1.613.019** zgjedhës, ose 47.86 % e tyre. Në vlerësimin e shkallës së pjesëmarrjes së zgjedhësve në votim duhet mbajtur parasysh fakti se në listat e zgjedhësve janë përfshirë edhe rreth **1 milion shtetas, të cilët jetojnë në emigracion** dhe mundësia e pjesëmarrjes së tyre në votim, pa ardhur në Shqipëri, ende nuk është rregulluar ligjërisht. Megjithatë u raportua që, në ditët para votimit, nga pikat e kalimit kufitar në jug të vendit, kanë hyrë rreth 7000 shtetas shqiptarë, të cilët mendohet se kanë votuar. Drejtuesi i Delegacionit të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës, Stewart Dickson u shpreh se *“nuk është normale që lista e zgjedhësve të përfshijë 1 milion zgjedhës që jetojnë jashtë Shqipërisë. Çështjet vendore duhet të vendosen nga shtetasit që jetojnë në fakt së bashku”*. Mendime për t'i riparë dispozitat ligjore që përcaktojnë kriteret dhe mënyrën e hartimit të listës së zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të pushtetit vendor, janë parashtruar edhe nga subjekte e ekspertë të tjerë, duke parashtruar si argumente jo vetëm ato të renditura nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 40, datë, 16.11.2007, por dhe faktin se prania e emrave të një grupi aq të madh zgjedhësish, që kanë një probabilitet tepër të ulët që të marrin pjesë realisht në votim, lë shteg për abuzim. Në vendimin e sipërcituar Gjykata Kushtetuese shprehet se *“...Megjithatë e drejta e votës nuk është absolute, ajo mund të bëhet objekt i kufizimeve.”* Në këto rrethana KSHH mendon se çështja meriton të studiohet dhe trajtohet, me qëllim që të gjenden zgjidhjet më të mira,



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

por pa cenuar, tej standardeve të pranuar, të drejtën e votës dhe me kusht që kufizimet që mund t'i bëhen kësaj të drejte të jenë të pakta dhe brenda kufijve kushtetues, pa cenuar thelbin e saj,² pasi e drejta e votës nuk është një privilegj që pushteti shtetëror u njeh shtetasve, por një instrument për të zgjedhur mënyrën dhe personat që do të qeverisin vetë ata. Kjo ka të bëjë në fakt me vetë thelbin e demokracisë. Megjithatë duket se ka një qasje të gjerë ndër vendet demokratike, lidhur me relacionin midis vendbanimit dhe të drejtës së votës për zgjedhjen e organeve të pushtetit vendor. Lidhur me këtë çështje Gjykata Kushtetuese Gjermane shprehet: *“Në këtë kuptim, vendbanimi është pika qendrore e marrëdhënieve jetësore të një njeriu. Është kërkesë ligjore që një person të ketë një vendbanim kryesor, brenda një juridiksioni të caktuar, me qëllim që të votojë, të punësohet ose të presë përfitime të tjera brenda këtij juridiksioni. Kushti për të pasur vendbanimin në zonën zgjedhore është një nga kufizimet e të drejtës së votës, e cila bashkë me kriterin e shtetësisë synojnë të vendosin një lidhje direkte, qoftë edhe minimale, midis votuesit dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në këtë mënyrë sigurohet legjitimiteti i votës në një zonë të caktuar.”*³

Nga vëzhgimet tona të pjesshme, rezulton se në këto zgjedhje, **listat e zgjedhësve janë hartuar më mirë dhe më saktë se në zgjedhjet e mëparshme.**

Listat paraprake me ekstraktet të përbërësve zgjedhorë, në përgjithësi, janë afishuar çdo muaj. Megjithatë, në disa raste afishimi i tyre është bërë vetëm dy muajt e fundit, ose ato janë afishuar në mënyrë që nuk mundësonte aksesin e plotë të zgjedhësve. Gabimet në listë u evidentuan nga vetë Zyrat e Gjëndjes Civile dhe rrallë nga ankesat e zgjedhëve. Këto të fundit, sipas informacioneve të marra nga njësitë e pushtetit vendor dhe zyrat përkatëse të gjëndjes civile, kanë qenë relativisht të pakta. Gabimet e konstatuara ose të referuara janë korigjuar përpara afishimit të listave përfundimtare.

Nga partitë politike ka patur pretendime për regjistrim fiktiv të zgjedhësve në Bashkitë Durrës, Kavajë dhe Vorë. Prokuroria nisi hetimin penal dhe verifikimin e këtyre pretendimeve të cilat nuk përfunduan përpara datës së zgjedhjeve dhe për pasojë këta persona u lejuan të votojnë në QV-të e qyteteve ku ishin regjistruar rishtazi. Hetimi i shpejtë dhe objektiv i kësaj çështjeje do të ndihmonte për zbardhjen e të vërtetës, vënies përpara përgjegjësisë ligjore të fajtorëve dhe për pasojë bërjen e procesit zgjedhor më të besueshëm e të drejtë në këto qytete. **Hetimi i këtyre akuzave duhet të shkojë deri në fund, ndonëse zgjedhjet kanë përfunduar dhe nëse rezulton se funksionarë të caktuar kanë mundësuar, në kundërshtim me ligjin, përfshirjen e zgjedhësve në lista të qyteteve të sipërshënuar, ose kanë lejuar që persona të tjerë të votojnë në emër të zgjedhësve që jetojnë jashtë vendit, ata duhet të ndëshkohen sipas ligjit.**

Në disa raste, listat e zgjedhësve u vendosën në vende të papërshtatshme dhe të paaksesueshme lehtësisht nga zgjedhësit, u vendosën në pozicion shumë lart për t'u parë me sy të lirë, ose janë vendosur pranë ambienteve publike, kryesisht arsimore, të cilat në orët e mbasdites ishin të mbyllura dhe nuk mundësonin konsultimin e listave nga shtetasit.

² Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Matthews kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 24833/94, (1999); *Labita kundër Italisë* Nr. 26772/95, (2000).

³ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, BVerfGE 36, 139/142.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Deri më datë 12.06.2015, KShH ka konstatuar një numër shumë të vogël të kërkesave të qytetarëve drejtuar gjykatave për të mundësuar ushtrimin e së drejtës së votës, por ato u shtuan me afrimin e datës së votimit. Kërkesa e bërë nga një shtetas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë **nxorri në pah çështjen e kompetencës lëndore të shqyrtimit të kërkesave të tilla. Konflikti i kompetencës u paraqitur për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe gjykata të tjera kanë mbajtur qëndrim tjetër, ato kanë vendosur t'i shqyrtojnë vetë kërkesat e zgjedhësve për ushtrimin e drejtës së votës, bazuar mbi dispozitat e KZ.** Nga Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) të ndryshme dhe Institucione të Paraburgimit (IP) u informuam se personat me liri të kufizuar, nëpërmjet stafëve të këtyre institucioneve kanë parashtruar një numër të madh kërkesash në gjykatat e rretheve gjyqësore përkatëse, për të kërkuar të drejtën e ushtrimit të votës, sepse nuk ishin përfshirë në listat përfundimtare të zgjedhësve.

Në këto zgjedhje, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në referim të nenit 18/1/c të Ligjit nr. 10 129, dt. 11.05.2009, "Për gjëndjen civile", ka kërkuar transferimin e vendbanimit të personave me liri të kufizuar nga ai që kishin para fillimit të vuajtjes së dënimit, në territorin e njërive administrative ku ndodhen IEVP-të, ose paraburgimet, ku është sistemuar i dënuari apo i paraburgosuri. Si pasojë, shumë të dënuar dhe të paraburgosur janë bërë pjesë e listave të zgjedhësve të QV-ve që u hapën pranë IEVP-ve, ose paraburgimeve përkatëse.

Në rastin e mësipërm, KShH ka konstatuar konflikt të legjislacionit në fuqi, për rrjedhojë dhe dyshime mbi zbatimin e drejtë të ligjit nga institucionet shtetërore përkatëse. Theksojmë se, Ligji nr. 10 129, dt. 11.05.2009, "Për gjëndjen civile", i cili është aplikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile bie ndesh me nenin 14 të Kodit Civil, në të cilin përcaktohet se, **vendi i vuajtjes së dënimit me burg është vendqëndrim dhe jo vendbanim i personit**, ndërsa neni 18, i Ligjit "Për gjëndjen civile" mundëson ndryshimin e vendbanimit nëse personi me liri të kufizuar ka me tepër se tre muaj qëndrim në një IEVP, ose paraburgim. Nga ana tjetër, nenet 56/1 dhe 165, të KZ përcaktojnë se zgjedhësit, me të drejtë vote, përfshihen në listat e zgjedhësve të QV-ve të territorit ku kanë **vendbanimin e tyre të përhershëm** dhe se ata **votojnë për zgjedhjen e organeve të pushtetit vendor të vendbanimit të tyre të përhershëm.** Pra, kriteri bazë për përfshirjen e shtetasve me të drejtë vote në listat e zgjedhësve **është vendbanimi**, por Kodi Civil dhe Ligji nr. 10 129, dt. 11.05.2009, "Për gjëndjen civile", kanë përcaktime të ndryshme për këtë institut. Bazuar në parimin e hierarkisë së normave ligjore (N.116, i Kushtetutës), Kodi Civil ka fuqi më të madhe ligjore. Nga ana tjetër në **Vendimin nr. 40, datë 16.11.2007, Gjykata Kushtetuese**, arsyetohet se *"...në rastin e zgjedhjeve vendore, e drejta e votës është e lidhur me vendbanimin dhe se midis zgjedhësit dhe të zgjedhurit duhet të ketë një lidhje më të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë"*. Më tej Gjykata Kushtetuese vazhdon: *"...Gjykata Kushtetuese çmon se kushtëzimi i të drejtës së votës me konceptin e "vendbanimit" në përmbajtjen e dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor nuk e bën atë antikushtetuese, përkundrazi ai garanton shprehjen direkte të vullnetit të zgjedhësit për drejtuesit e njësisë vendore ku ai banon."*, gjë që është vështirë të vërtetohet në rastin e personave me liri të kufizuar, të cilët gjatë vuajtjes së dënimit mund të ndryshojnë vendqëndrimin e tyre nëpërmjet institucioneve të ndryshme penitenciare, për shumë arsye. Për këtë mund të vendos administrata e burgjeve, nisur nga interesa të administrimit të të burgosurve; mund të jetë pasojë e miratimit të kërkesave të të burgosurve, mund të jetë pasojë e një vendimi gjyqësor, ose si nevojë për



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

trajtimin e veçantë të personit me liri të kufizuar, si trajtimi shëndetësor etj. Për pasojë vendqëndrimi i këtyre shtetasve me liri të kufizuar nuk ka stabilitet. Për këto arsye **KSHH mbështet rishikimin e situatës së legjislacionit vendas në këtë drejtim dhe sugjeron përmirësimin dhe unifikimin e tij sa më parë, me qëllim që të shmanget çdo keqinterpretim dhe keqpërdorim i mundshëm i të drejtës së votës për personat me liri të kufizuar, në kuadër të zgjedhjeve vendore.**

V. Informimi dhe sensibilizimi i zgjedhësve

Nga takimet me zgjedhës që votonin për herë të parë, zgjedhës të zonave rurale, por jo vetëm, KShH ka konstatuar **mungesë informimi dhe sensibilizimi të votuesve** lidhur me listat e ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë, si dhe listat përfundimtare të zgjedhësve, ose për rëndësinë dhe mundësinë e korigjimit të tyre. Zgjedhës të ndryshëm të kontaktuar nga ana jonë, veçanërisht ata të komunitetit Roma, nga minoritetet etnike Serbo-Malazeze, Greke dhe Maqedonase, **na parashtruan shqetësimin se njoftimi me shkrim i tyre në banesë, lidhur me përfshirjen në lista dhe qendrën përkatëse të votimit, nuk ishte kryer siç urdhëron ligji** (n. 52, i KZ). Megjithatë konstatuam se në disa bashki, ky lajmërim ishte bërë rregullisht, si p.sh. në Lushnjë, Berat, Korçë, etj. **Ministria e Brendshme nuk alokoi, sipas ligjit, fondet e posaçme për këtë qëllim (n. 50, i KZ)** dhe atje ku njoftimi është kryer, ai është përballuar me fonde të bashkive përkatëse.

Në fazën e procesit parazgjedhor, mediat kanë vazhduar të fokusuar më shumë në debate me karakter politik dhe nuk kanë ndihmuar sa duhet për sensibilizim e informim të zgjedhësve për procesin e votimit. Veprimtari informuese dhe sensibilizuese për zgjedhësit janë zhvilluar vetëm nga një grup i OJF-ve vendase, të financuara kryesisht nga Ambasada Amerikane në Tiranë, por mendojmë se ato nuk janë të mjaftueshme për të patur një impakt sa më të gjërë në publik. Në ditët e fundit para votimit, KQZ përgatiti dhe trasmetoi në mediat elektronike spote publicitare, si dhe prodhoi postera sensibilizues për mënyrën e votimit. Gjithashtu, u vërejt se edhe disa drejtues të subjekteve politike dhe kandidatët e tyre në këto zgjedhje, ditët e fundit përpara votimit u bënë thirrje zgjedhësve të merrnin pjesë në votim. Mbetet detyrë që administrata zgjedhore dhe institucionet publike të punojë më shumë në këtë drejtim.

Grupet politike në Kuvend dhe përfaqësues të organizmave ndërkombëtare të akredituara në vend parashtruan çështjen e “dekriminalizimit” të listave të kandidatëve, ose strukturave të pushtetit publik. Megjithatë reagimi i subjekteve politike vendase mbeti në nivelin e retorikës politike dhe nuk solli përmirësime të legjislacionit në këtë drejtim. Me ndonjë përjashtim të rallë, nuk pati veprime konkrete për të mënjeluar kandidatët e dyshuar si të inkriminuar. Organet e drejtësisë nuk dhanë informacion, ose ndihmën e duhur për qartësimin e situatave për kandidatë konkretë dhe nuk sollën fakte në këtë drejtim. **Zgjedhësit mbetën të painformuar plotësisht lidhur me emrat e kandidatëve konkretë të dyshuar si të inkriminuar, si dhe për forcat politike që i kishin përfshirë ata në listat e tyre.** Ata shprehën shqetësim, veçanërisht, për integritetin e kandidatëve, sepse nuk dëshironin që vota e tyre të shkonte në favor të kandidatëve të inkriminuar. Kjo mangësi e fushatës, së bashku me mosqartësimin deri në fund të rasteve të kandidatëve të inkriminuar, penguan zgjedhësit të krijojnë në mënyrë të pavarur bindjen e brendshme që do t'i udhëhiqte për dhënien e votës.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

VI. Administrimi i zgjedhjeve

Në bazë të ligjit, administrimi i zgjedhjeve realizohet nga KQZ, KZAZgjedhor, KQV dhe Grupet e Numërimit të Votave (GNV). Veprimtaria e administratës zgjedhore të nivelit të dytë e të tretë (KZAZ dhe KQV) tregoi, nganjëherë, kapacitete jo të mira për menaxhimin e zgjedhjeve. Duket se cilësia e trajnimit dhe ndryshimi i shpeshtë i komisionerëve janë faktorë që ndikuan në mungesën e aftësive dhe njohurive mbi rregullat e administrimit të zgjedhjeve.

a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

KSHH ka monitoruar pjesërisht funksionimin e KQZ-së, mbledhjet e së cilës kanë qënë të hapura. Aty është diskutuar gjithë problematika si dhe janë marrë vendime, me transparencën e duhur, lidhur me aspekte të ndryshme të organizimit të procesit zgjedhor. KShH mendon se, **KQZ ka përballuar përgjithësisht mirë veprimtarinë e administrimit të procesit zgjedhor, duke qënë më efikase dhe operative se në të kaluarën.** Ajo është përpjekur të japë zgjidhje për problemet e shumta që iu parashtruan, duke manifestuar iniciativë dhe “guxim”, në kushtet kur legjislacioni zgjedhor nuk u përmirësua në të gjitha drejtimet ku ishin evidentuar nevojat. Megjithatë, KQZ nuk siguroi dot që të gjithë materialet zgjedhore të përgatiteshin në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe i shpërndau ato tej afateve të parashikuara nga pika 1, e nenit 99 të KZ (*si në KZAZ nr. 23, 29, 31, 35, 37, 39, 42, Bashkia Tiranë, KZAZ nr. 78, Bashkia Gjirokastrë, KZAZ nr. 81-84, Bashkia Vlorë, KZAZ nr. 71 dhe 72, Bashkia Korçë, etj.*)

Në aspektin funksional, lidhur me miratimin e vendimeve dhe udhëzimeve, KQZ është paraqitur më mirë se në zgjedhjet e mëparshme. Megjithatë, vendim-marrja e KQZ nuk qe gjithmonë bindëse, përse i përket bazueshmërisë në legjislacionin në fuqi dhe në ndonjë rast anëtarët nuk mundën të shmangin influencat e forcave politike që i kanë përzgjedhur. Pati raste të mungesës së konsequencës në arsyetimin e vendim-marrjes nga ky organ. KShH ka rezerva lidhur me vendim-marrjen e KQZ-së, e cila ka mbajtur qëndrime kontradiktore në rastet e kandidatëve për kryetarë të Bashkisë Kurbin dhe Këlcyrë. Në rastin e parë, KQZ zbatoi në mënyrë strikte procedurën ligjore të regjistrimit të kandidatëve, sipas KZ, ndërsa në rastin e çregjistrimit të kandidatit për Kryetar Bashkie Këlcyrë, KQZ vendosi pa bazë të qartë ligjore.

b) Komisionet e Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të)

KZAZ-të u ngritën me vonesë⁴ për shkak të ndryshimeve të vonuara të KZ⁵. Krijimi i kushteve për mirëfunksionimin dhe realizimin e transparencës së veprimtarisë së këtyre organeve të administrimit të zgjedhjeve ka lënë për të dëshiruar. KShH ka konstatuar mungesë të bazës materiale/logjistike, mjedise pune të papërshtatshme, vendosje, në ndonjë rast, të KZAZ-ve në godinën e bashkive, në kundërshtim me nenin 93, pika 2/b të KZ, si në Përmet, Tepelenë, Korçë.

⁴ Shih Deklaratën e KShH “Nuk duhet vonuar me ngritjen e KZAZ-ve”, Datë 8 Prill 2015

⁵ Shih Deklaratën e KShH “Vonesat janë me pasojë për procesin zgjedhor”, Datë 13 Shkurt 2015



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Me përjashtime të rralla, KZAZ-të nuk kishin të afishuar në derën e zyrës përbërjen e komisionit, orarin e veprimtarisë dhe rendin ditës së mbledhjeve të planifikuara. Kjo ka penguar transparencën e veprimtarisë dhe vendim-marrjes së këtyre organeve të administrimit zgjedhor, duke vështirësuar marrjen e informacionit nga vëzhguesit e KSHH-së, por jo vetëm, lidhur me aspekte të administrimit të zgjedhjeve.

Është vërejtur se ka patur ndryshime ose zëvendësime të anëtarëve të KZAZ-ve, si para ashtu dhe pas procesit të votimit. Ky fakt që nuk ndihmoi për trajnimin efektiv dhe mirëfunksionimin e këtyre organeve. Rasti më i njohur është ai i shkarkimit nga KQZ, të kryetarit dhe dy anëtarëve të KZAZ-së nr. 15, (Bashkia Kurbin). Shkarkimi i tyre u bë në orën 23.00, të dt. 20.06.2015, disa orë para fillimit të votimit, ndonëse u emërua kryetari i ri i kësaj KZAZ-je.

Deri në ditët e fundit para ditës së votimit është vënë re ndryshim i shpeshtë i anëtarëve të KZAZ-ve, si në KZAZ nr. 01 (Bashkia Malësi e Madhe), KZAZ nr. 3, nr. 04 (Bashkia Shkodër), KZAZ nr. 07 (Bashkia Pukë), KZAZ nr 09 (Kukës), KZAZ nr. 69 dhe nr. 70 (Korçë), KZAZ nr. 63 (Berat), KZAZ nr. 18 (Dibër), KZAZ nr. 56 dhe nr. 57 (Fier), KZAZ nr. 81, nr. 85 dhe nr. 86 (Vlorë), etj. Ndryshime të anëtarëve të KZAZ janë vënë re edhe gjatë procesit të numërimit të votave si, në KZAZ nr. 7 (Bashkia Shkodër), KZAZ nr. 39 (Bashkia Tiranë), KZAZ nr. 55, (Bashkia Lushnjë), etj. Kjo praktikë është kritikuar edhe në zgjedhjet e kaluara nga OSBE/ODIHR, por vazhdon të mos gjejë përmirësim.

KQZ ka evidentuar faktin e mos-pjesëmarrjes në trajnimet e organizuara prej saj, të anëtarëve të KZAZ-ve dhe të KQV-ve në Shkodër, Gjirokastër dhe Sarandë⁶. Kjo flet për papërgjegjshmërinë e këtyre personave ndaj detyrës prandaj subjektet zgjedhore, që i kanë caktuar, jo vetëm duhet të bëjnë përzgjedhje më të mira në të ardhmen për personat që emërojnë në këto detyra, por dhe ti nxisin e ti kontrollojnë ata që të marrin pjesë në trajnimet që organizom KQZ, me qëllim që të rritin kapacitetet dhe të aftësohen për të kryer detyrën.

KZAZ-të nuk dispononin të dhëna lidhur me cilësitë, karakteristikat, ose vendbanimin e kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiake. Për pasojë, duke patur parasysh se edhe subjektet zgjedhore nuk i prezantuan sa duhet ata gjatë fushatës, nuk u bë e mundur që zgjedhësit e interesuar të merrnin informacion të mjaftueshëm rreth tyre.

Siç kemi nënvizuar edhe më lart, përfaqësues të organizmave ndërkombëtare, të akredituara në Shqipëri, ngritën alarmin se në listat e kandidatëve ishin përfshirë dhe persona të inkriminuar. Gjatë vizitave tona në rrethe, zgjedhësit na shprehën shqetësim në këtë drejtim, sepse ata nuk duan të japin votat e tyre për këta persona. Që vota të jetë e lirë nuk mjafton vetëm të mos ndërhyhet në ushtrimin e saj, por është po aq e rëndësishme që zgjedhësit të votojnë të ndërgjegjësuar dhe të bindur objektivisht për kandidatin që preferojnë.

Lidhur me çështjen e materialeve zgjedhore u konstatua se në QV nr. 1459, Bashkia Durrës dhe në QV nr. 1266, Bashkia Krujë, anëtarë të KZAZ-së përkatëse kanë tërhequr nga 100 fletë votimi, të papërdorura, duke pretenduar se nevojiteshin për QV-të e institucioneve të vuajtjes së dënimeve penale. Lidhur me këtë veprim nuk u bë e qartë nëse këta persona

⁶ Deklarata e KQZ-së, Datë 15.06.2015



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ishin të autorizuar nga KQZ. Gjithsesi ky është një fakt që hedh dritë mbi planifikimin dhe shpërndarjen e bazës materiale jo gjithmonë në përputhje me nevojat e QV-ve.

c) Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV-të)

Niveli i kualifikimit të anëtarëve të KQV-ve, përsa i takon njohurive të administrimit të procesit zgjedhor ka qënë jo gjithmonë i mirë. Zëvendësimi i shpeshtë i tyre dhe mungesa e trajnimit për një pjesë të tyre, kanë ndikuar ndjeshëm në cilësinë e menaxhimit të procesit zgjedhor nga këto struktura. Kjo ka reflektuar si në procesin e hapjes së QV-ve gjatë ecures së procesit të votimit, si dhe në atë të mbylljes së votimit.

E vlerësojmë me vend të përmendim disa sjellje të anëtarëve të QV-ve, që vijnë në kundërshtim me ligjin, si p.sh ajo në QV nr. 1853/1, në QV nr. 1885, në QV nr. 4398, Bashkia Vlorë, ose QV nr. 4507/2, Gjirokastrë që **mbanin veshje me simbole partiake ose shenja dalluese të subjekteve politike**; sjelljen e tyre në QV nr. 1853/1 (Ambulanca, Selitë), ku **vëzhguesja e KShH është penguar të hyjë në QV, deri në orën 08.15**, ndërkohë që brenda ambienteve të QV kanë qënë të pranishëm vëzhgues të subjekteve zgjedhorë politike; raste të ndërhyrjes së anëtarëve të KQV-së për të kryer procesin e palosjes ose hedhjes në kuti të fletës së votimit të zgjedhësit; mosveprim në përputhje me ligjin në rastet kur zgjedhësi ka fotografuar votën e tij, mos-evidentimi në procesverbal i rasteve të votimit familjar, të votimit me mbështetje të një zgjedhësi tjetër, etj.

Ka patur dhe raste të pakta, kur anëtari i QV-së i ngarkuar për ruajtjen e radhës nga votuesit nuk e kreu detyrën në përputhje me nenin 105, pika 2, e KZ, ku thuhet se, *“një prej anëtarëve, i caktuar me vendim të KQV-së, kujdeset për ruajtjen e radhës së votimit të zgjedhësve”* Kjo u konstatua p.sh. në QV nr. 1573/3, 4241, etj.

Vëzhguesit e KShH kanë referuar raste të sjelljes së paligjshme të komisionerëve, të cilët kanë refuzuar të marrin Vërejtjen me Shkrim të paraqitura nga vëzhguesit. Madje, në një rast, në kundërshtim me Nenin 6 të KZ, anëtarët e KQV-së kanë komunikuar me gjuhë të ashpër dhe kanë tentuar për të nxjerrë jashtë vëzhguesin. Kjo ndodhi në QV nr. 1691/1, tek Shkolla Nëntëvjeçare “Ali Demi”, Bashkia Tiranë.

Ngritja e KZAZ-ve dhe KQV-ve në bazë të propozimeve të partive politike parlamentare ndikon në qëndrimet dhe veprimet që komisionerët manifestojnë gjatë përmbushjes së detyrës, duke manifestuar njëanshmëri politike, në favor të forcës që i ka caktuar, megjithëse ky fenomen në këto zgjedhje vendore ka qënë më i kufizuar.

VII. Regjistrimi i kandidatëve

Listat e kandidatëve për këshilltarë dhe kandidatët për kryetarë bashkie u regjistruan në afat dhe në mënyrën e parashikuar nga ligji. Rritja e kuotës gjinore në masën 50% në listat e mbyllura të subjekteve zgjedhore dhe sanksionimi ligjor i të drejtës së refuzimit nga KQZ-ja të listës, në rast të mospërmbushjes së këtij detyrimi, përbën një hap të rëndësishëm që mundësoi rritjen e pjesëmarrjes së grave në këshillat bashkiake të dala nga këto zgjedhje. Megjithatë nuk ishte e mundur të gjendej dhe merrej informacioni zyrtar lidhur me kandidatët që ishin banorë të zonave rurale, të përfshira në bashkitë me dimensione të reja, të krijuara pas reformës administrative, ose informacioni mbi kandidatët që vinin nga



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

grupet e shtetasve të pakicave. Kjo mangësi vinte për shkak të mungesës së parashikimeve në ligj që të detyronte marrjen e këtij informacioni dhe bërjen e tij publike, për ata që mund të jenë të interesuar në këtë drejtim.

Si fenomen i ri u manifestua dorëheqja e ndonjë kandidati dhe kërkesa e ndonje subjekti zgjedhor për të hequr nga lista e vet ndonjë kandidat. Me këtë rast u konstatua se dispozitat përkatëse të KZ nuk parashikonin rregullime të qarta për iniciativa të tilla, prandaj sugjerojmë që KZ të plotësohet në këtë drejtim, por në këtë rast mendojmë se do të jetë më mirë që subjektet zgjedhore të mos kenë të drejtë të zëvendësojnë kandidatët pas plotësimit të afatit ligjor për dorëzimin e listës së tyre. Nëse ndodh dorëheqja ose largimi nga lista e ndonjë kandidati, vendet e tyre duhet të mbetën vakant. Këtë propozim e mbështetim në dy argumente: **së pari** sepse qëndrim të ngjashëm mban ligji në lidhje me zgjedhësit, të cilët nuk mund të bëjnë ndryshime në listën e zgjedhësve, pas shpalljes së listës përfundimtare, veçse me vendim gjyqësor dhe, **së dyti**, kjo do t'i detyronte subjektet politike t'i studiojnë më mirë kandidatët e tyre dhe nëse nuk e bëjnë këtë, duhet të vuajnë konsequencën.

Proçesi i regjistrimit të kandidatëve dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë, garues në këto zgjedhje, u bë objekt kundërshtimi dhe vendim-marrjeje në KQZ, si dhe në Kolegjin Zgjedhor, por këto organe nuk treguan konsequencë në argumentimin e vendim-marrjes së tyre. Këto organe të larta të administrimit të zgjedhjeve manifestuan problem edhe në drejtim të arsyetimit, ose publikimit në kohë të vendimeve të tyre, gjë që çoi në transparencën e veprimtarisë së këtyre organeve publike.

VIII. Proçesi i votimit

Dita e zgjedhjeve ka qenë në përgjithësi e qetë dhe zgjedhësit kanë shkuar dhe kanë votuar lirshëm, e pa presione në qendrat e votimit, ndonëse është vënë re një aktivizim i militantëve të të gjitha forcave politike për t'i nxitur zgjedhësit, ose shoqëruar ata nga banesa e tyre drejt QV-ve përkatëse për të votuar.

Janë ngritur pretendime nga disa subjekte zgjedhore në lidhje me manipulimin e zgjedhësve, por ata nuk bënë denoncime dhe nuk parashtruan përpara organeve kompetente prova në këtë drejtim. Gjithashtu ka patur pretendime nga pozita e opozita, si dhe nga ojf të ndryshme për blerje të votave, por edhe këto pretendime nuk janë përcjellë pranë organeve të ndjekjes penale. Nga ana tjetër asnjë organ i drejtësisë nuk na rezulton të ketë filluar ndjekje penale ose të ketë dhënë vendim për ndonjë vepër penale të tillë, sipas parashikimeve të Kodit Penal, sepse pritej që organet e drejtësisë të vepronin me iniciativë ndaj këtyre akuzave të bëra publikisht .

Proçesi i votimit është zhvilluar përgjithësisht në përputhje me ligjin, në bashkitë e monitoruara nga KShH. Megjithatë u manifestuan disa probleme në lidhje me çështjet si vijon:

a) *Baza materiale*

KQZ nuk garanoi që të gjithë materialet zgjedhore të përgatiteshin në sasinë e cilësinë e duhur dhe i shpërndau ato tej afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor. **Në KZAZ-të e monitoruara rezulton se, baza materiale zgjedhore është shpërndarë drejt KZAZ-ve**



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

me vonesë, në shkelje të afatit të parashikuar nga pika 1, e nenit 99, të KZ. Kjo u konstatua në KZAZ nr. 23, 29, 31, 35, 37, 39, 42, Bashkia Tiranë, KZAZ nr. 78, Bashkia Gjirokastrë, KZAZ nr. 81-84, Bashkia Vlorë, KZAZ nr. 71 dhe 72, Bashkia Korçë, etj.

Për rrjedhojë, këto KZAZ kanë shpërndarë me vonesë bazën materiale për QV-të përkatëse, proces i cili është përfunduar pas orës 16.00 të dt. 20 Qershor 2015, në shkelje të pikës 1, të nenit 100 të KZ, ku përcaktohet një afat jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit.

Kur zgjedhësit janë paraqitur në QV për të votuar, në disa raste nuk iu janë kontrolluar të dyja duart, për të verifikuar nëse ishin shenjuar, duke mos respektuar Nenin 105, Pika 1, germa b, të KZ, ku thuhet se, *“një prej anëtarëve, i caktuar me vendim të KQV-së kontrollon zgjedhësit në të dy duart, në çastin e paraqitjes para KQV-së dhe para marrjes së fletës së votimit, nëse është timbruar ose jo me lëndën e posaçme”*. Kjo është konstatuar në QV nr. 1573, 1573/2, 1573/3, 1573/4, 1615, 1615/2, 1615/3, 1615/4, 1828, 3687/1, 1741/1, 1975, 1915, 4507/1, 1703, 1699, 1828, 1699, 1703, 1715/1, 1715, 1741/2, 3011, 3011/1, 3011/2, 3013/1, 3013, etj. Gjithashtu, është vërejtur se, në ndonjë rast është timbrosur dora e djathtë, ndonëse KZ përcakton se, *zgjedhësi timbroset në dorën e majtë*. Kjo u vërejt shpesh në shumicën e QV të vëzhguara në Bashkinë Elbasan, në QV nr. 4491, 4961, 1741/1, 1980, 3011/1, 3013/1, 1830, 1741/1, 1975, etj.

Në disa QV boja e timbrosjes mund të fshihej lehtësisht, në kundërshtim me Nenin 105, Pika 1, Germa dh) të KZ, ku përcaktohet se timbrosja bëhet me *lëndë të posaçme, të dukshme me shikim të lirë dhe që nuk hiqet për jo më pak se 24 orë, ...*” Kjo u konstatua në disa QV të Bashkisë Tiranë, Elbasan dhe Korçë, si p.sh. QV nr. 1875/1, QV nr. 1875/2, QV nr. 1876/1

b) Respektimi i orarit të hapjes së QV-ve

Në më shumë se 50% të QV të monitoruara nga KShH, procesi i votimit ka filluar me vonesë, nga 15- 40 minuta dhe në disa raste, edhe më vonë. Si shkaqe të vonesave raportohen: puna e ngadaltë e komisionerëve në shqyrtimin e materialeve zgjedhore dhe përshtatjen e QV; moskordinimi dhe mungesa e informimit të anëtarëve të QV lidhur me radhën e kryerjes së veprimeve si dhe ndarja e detyrave midis tyre; mosmarrëveshjet midis anëtarëve të QV për arsye të ndryshme; mungesa ose gabimet lidhur me bazën materiale; prezenca e propogandës politike në distancë më pak se 150 m nga QV-ja; sjellje jo korrekte e ndonjë anëtari, si ajo e atij që hodhi vulën nga dritarja; zëvendësimi të ndonjë anëtari të KQV para hapjes së votimit; mosparaqitjes në kohë të komisionerëve, si p.sh. në QV nr. 1573, 1804, 1615/1, 1853/1, 1949/1, 1853, 1875/2, 2000/1, 3648, 3675, 3706, 4264, 4278, 4283, 1828, 3675, 0652, 0650/1, 1438/1, 1440/1, 1433, 1432, 1432/1, 1433/1, 1430/1, 1430/2, 1430, 1428/1, 1428, 1427, 1428/2, 1410/1, 1838/1, 1840, QV nr.1699, 1757, 1977, 1977/1, 1838, 1840/1, 1841, 1841/1, 1839, 1767, 1741/1, 1748/1, 1731/1, 1731, 1730, 1986, 1986/1, 1989/1, 1989, 1939/1, 3030, 3023, 3023/1, 3004, 2998, 3088, etj.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Vonesë në këtë drejtim shkaktuan gabimet materiale në shtypjen e fletëve të votimit në Bashkive Roskovec, Tepelenë dhe Devoll, gjë që solli shtyrjen e gjatë të fillimit të procesit të votimit në këto bashki.

c) Situata e rregullit dhe ligjshmërisë gjatë procesit të votimit në QV

Përgjithësisht, QV-të ishin të vendosura në institucione publike dhe shtetërore si universitete, shkolla, kopshte, institucione shëndetësore, sportive dhe në disa raste në lokale private.

KShH konstatoi se, **në ndonjë rast KQV-të kishin organizuar në mënyrë të gabuar mjedisin e QV-ve, ku dhoma e fshehtësisë nuk garantonte fshehtësinë e votës**, gjë që vjen ndesh me pikën 1, të nenit 109, të KZ. Kjo u konstatua në tre QV në Bashkinë Tiranë, konkretisht në QV nr. 1890, QV nr. 1883/1 dhe në QV nr. 1890. Theksojmë se pas vërejtjeve të vëzhguesve të KShH, komisionerët kanë marrë masa për rregullimin e gjendjes.

Janë vërejtur simbole të subjekteve politike në afërsi të QV, në kundërshtim me ligjin, të cilat duhet të ishin larguar përpara fillimit të votimit, konstatuar në QV nr. 1974/1, QV nr. 1703/1, QV nr. 0271, QV. 02711, 0272, 02721 dhe 0273, Bashkia Shkodër, në QV nr. 1804, 1804/1, 1805, 1806, 1806/1, 1807, Bashkia Tiranë, etj.

Janë konstatuar raste të **votimit të zgjedhësve, mbiemri i të cilave nuk kishte përputhshmëri midis kartës së identitetit dhe listës së zgjedhësve**. Komisionet lejuan votimin me pretendimin se ato zgjedhëse, pas celebrimit të martesës, nuk kishin përgatitur kartë identiteti të re me mbiemrin që kishin marrë pas martesës, megjithëse në Nenin 105, Germa c) të KZ thuhet se, *“kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve....”* Kjo është konstatuar në QV nr. 1828, 1699/1, 1757/1, 1709, 1989/1.

Në disa QV nuk i hiqej vizë në listë emrit të zgjedhësit pasi votonte, në kundërshtim me sa përcaktohet në Nenin 105, Germa c) të KZ, ku thuhet se, *“kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë të dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë”*. Kjo është konstatuar p.sh. në QV nr. 1615/3, 1615/4, 1741, 1741/1, 1741/2, 1740/1, 1740, 3179, megjithatë thekojmë se zgjedhësit që votuan, në të gjitha rastet kanë nënshkruar pranë emrit të tyre.

Janë konstatuar raste ku **anëtarët e KQV-së nuk kanë kryer kontrollin e gishtave të zgjedhësve**, një masë sigurie për ndalimin e votimit dy herë nga i njëjti zgjedhës. (në QV nr. 1741/1 dhe QV nr. 1975, QV nr. 1915, QV nr. 4507/1, QV nr. 1703, QV nr. 1699, qv nr. 1828).



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Votimi i zgjedhësve me vendim gjykate është kryer në përputhje me ligjin. Të dhënat e zgjedhësit, në këtë rast, janë regjistruar në një regjistër të posaçëm të cilit i bashkëngjitej edhe vendimi i gjykatës, siç përcaktohet në N. 57, Pika 4, të KZ. Me vendim gjyqësor kanë votuar dhe një numër i madh personash me liri të kufizuar, të cilët nuk e lishin emrin në listat e QV-ve të ngritura pranë institucioneve penitenciare.

Në ndonjë rast, KQV nuk ju kanë dhënë kopje të Proçesverbalit për Mbylljen e Votimit vëzhguesve të partive parlamentare, siç parashikohet në N. 113, Pika 6, të KZ, ku thuhet se, “*kopje e Proçesverbalit për Mbylljen e Votimit u jepën anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare*” Kjo u konstatua p.sh. në QV nr. 1947, 3635.

Në disa QV anëtarët e KQV-së kanë votuar gjatë proçesit të votimit, në kundërshtim me nenin 106, Pika 4 të KZ, sipas të cilit, “*anëtarët dhe sekretari i KQV votojnë pasitë kanë votuar të gjithë zgjedhësit e pranishëm në qendrën e votimit brenda orarit të mbylljes së votimit*” Kjo u vërejt në QV nr. 1875, 1875/1, 1876/2, 2003/1, 2003, 3650, 3690, 3690/1, 3689, 3689/1, 4429, 4507/2, 4507, 4436, 3011, 3011/1, 3013/1, 3013, etj.

Në QV-të me nr. 1883, 1883/1, 1910, 19101, 1911, 1911/1, 1912, 1912/1, 1912/2, 1914, 1914/1, 1915, 1915/1, 1916 dhe 1916/1 **kanë ndjekur një praktikë të kundraligjshme e të paparashikuar nga KZ**. Konkretisht në këto QV, pasi votuesit i jepej fleta e votimit, kryetari i komisionit njoftonte me zë të lartë emrin, mbiemrin e votuesit si dhe nr. rendor në listë, me qëllim që të viheshin në dijeni vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, të cilët mbanin shënime për zgjedhësit që votonin. Komisionerët pretenduan se kështu ishin udhëzuar nga KQZ-ja. KSHH konstaton se kjo proçedurë nuk parashikohet në nenin 105 të KZ, ku pasqyrohet rregullat e paraqitjes së votuesit në qendrën e votimit deri në përmbushje të së drejtës të votës. Nga ana tjetër kjo sjellje e komisionerëve të QV shkakton cenim të privatësisë së zgjedhësit.

Fotografimi i votës u konstatua në QV nr.1728 të Tiranë dhe përdorimi i celularit në QV nr. 3011 të Fierit.

d) Ndërprerje të proçesit të votimit

Ditën e zgjedhjeve, proçesi i votimit ka vijuar përgjithësisht pa ndërprerje. Megjithatë, KZAZ-të përgjegjëse për Bashkitë Roskovec, Tepelenë dhe Devoll kanë pezulluar përkohësisht proçesin e votimit për shkak të gabimeve materiale në fletët e votimit. KQZ vendosi të urdhërojë këto KZAZ të fillojnë menjëherë proçesin e votimit, në të gjitha qendrat e votimit të juridiksionit të tyre, duke përdorur për votim ato fletë votimi, ndonëse me gabime. Në Bashkinë Himarë, QV nr. 4591, ka mbyllur votimin dhe ka rifilluar atë disa herë, për shkak të mosmarrëveshjeve midis vëzhguesve dhe anëtarëve të KQV-së. Gjithashtu ndërprerje janë shkaktuar, në ndonjë rast sporadik, për shkak të përdorimit të telefonit celular dhe fotografim të votës; ose sepse anëtarët e KQV kanë votuar gjatë proçesit dhe jo në mbylljen e tij, siç parashikon ligji; ose për mosregjistrim të Deklaratës përkatëse në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të QV, kur një votues ndihmonte një votues tjetër që nuk mund të votonte vetë; si dhe për ndalimin e votimit familjar; etj. Këto janë konstatuar në QV nr. 4278, 1804, 3706/1, 3707, 3709/1, 3706, 3687/1, 3695/2, 1828,



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

3655/1, 3690, 3690, 3690/1, 3689, 3689/1, 3689, 3691, 2000/1, 1615/1, 1853/1, 1876/1, 2115, 1876/1, 2002.

e) *Votimi familjar*

Janë konstatuar raste të votimit familjar, në kundërshtim me Nenin 106, Pika, të KZ, ku thuhet se, *pasi merr fletën e votimit, zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë...* Kjo është konstatuar në QV nr. 1875/3, nr. 1876/1, 1876/2, 2002, 7674/1, 3673/1, 3695, 3695/2, 1699/2, 1703, nr. 2041/1 në Tiranë, nr. 4278 e Bashkisë Gjirokastrë, në QV nr. 4591/1 të Bashkisë Himarë, në QV nr. 2504, nr. 4590, nr. 4590/1 të Bashkisë Elbasan, në QV, nr. 4591/1 të Bashkisë Himarë, etj. Megjithatë rastet e raportuara të votimit familjar nga vëzhguesit e KSHH tregojnë se ka rënie të fenomenit, në krahasim me zgjedhjet e mëparshme. Në disa prej këtyre rasteve, KQV ka ndërhyrë duke ndaluar votimin e tyre në grup, por ndonjëherë ato toleruan fenomenin dhe nuk bënë ndërhyrjet e duhura për t'i ndaluar këto veprime të kundraligjshme. Sugjerojmë që në analizën e veprimtarisë së zgjedhjeve të 21 Qershorit 2015, KQZ të ndalet në mënyrë të veçantë lidhur me këtë çështje, të bëjë dallimin midis votimit familjar dhe rasteve të votimit me anë të ndihmësit, kur votuesi nuk është në gjendje të votojë vetë dhe mbi të gjitha të analizojë shkaqet përse KQV-të nuk mbajtën qëndrim ligjor, në disa raste, ndaj votimit familjar, ndonëse u vunë në dijeni për këtë nga vëzhguesit e pranishëm.

f) *Votimi i personave me aftësi të kufizuar*

Është konstatuar se shumë QV ishin vendosur në mjedise të papërshtatshme për zgjedhësit me paaftësi të lëvizjes dhe se organet e qeverisjes vendore dhe zyrat e gjendjes civile nuk i spostuan emrat e këtyre zgjedhësve në QV të përshtatshme, përpara afishimit të listës përfundimtare të zgjedhësve, siç parashikohej në Udhëzimin e KQZ. Gjatë vëzhgimit monitoruesit e KSHH konstatuan raste kur votues me paaftësi, ose të moshuar, nuk ishin në gjendje të ngjithnin shkallët e godinave, ku ishin vendosur QV-të dhe Komisionerët nuk kishin marrë masa për të lehtësuar e ndihmuar lëvizjen e këtyre zgjedhësve. Nga ana tjetër, premtimi i bërë nga KQZ se votimi i të verbërve do të kryhej me mjete të posaçme e të përshtatshme për ta nuk u realizua. Kjo nuk krijoi kushtet e nevojshme për respektimin e fshehtësisë së votës për këta zgjedhës.

Votuesit, që për paaftësi fizike nuk mund të votonin vetë, në shumicën e rasteve janë ndihmuar nga familjarët e tyre (bashkëshortë, fëmijët), fqinjët e tyre, siç parashikohet në N. 108, të KZ. Kjo është konstatuar p.sh. në QV nr. 1573, 1573/1, 1573/2, 1432, 1430/1, 1427/1, 1427, 1428/2, 1429/1, 1429, 1410/1, 1411/1, 1699, 1699/2, 1699/1, 1703, 1757, 1709, 1709/1, 1708/1, 1838, 1838/1, 1840, 1840/1, 1841, 1841/1, 1839, 1767, 1885/2, 1894/1, 1895/1, 1748/1, 1748, 1741/2, 1740/1, 1740, 1731/1, 1730/1, 1730, 1728, 1986, 1987/3, 1986/1, 1989/1, 1989, 1939/1, 1940/1, 1936/1, 1931, 1936, 3030/1, 3032, 3031, 3028, 3023, 3023/1, 3023/2, 3025, 3028/1, 3000, 2999/1, 2984/1, 3011/1, 3011/2, 3013/1, 3013, 2986/1, 3179, 3178, 3178/1, 3176, 3177, 3004, 3005/2, 3005/1, 3022/2, 3022/1, 2994, 2997, 3048/1 – 2 raste, 3045/1, 3116, 3117, 3088. Megjithatë janë vërejtur raste të mangësive në procedurën e votimit të personave me aftësi të kufizuar, duke mos respektuar kriteret ligjore për personin që ndihmonte, ose duke mos pasqyruar me shkrim, sipas ligjit, rastet e ofrimit të ndihmës për këtë kategori zgjedhësish. Kjo u konstatua në QV nr. 2110,



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

nr. 2115, nr. 1715, nr. 1741/1, nr. 1741/2, nr. 1767, nr. 1691, nr. 1852/1, 1875/2, 1876/1, 1853/1, etj.

g) Votimi në institucione të posaçme

Sipas KZ, “*Institucione të posaçme*” janë burgjet, vendet e paraburgimit si dhe spitalet dhe institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tre ditë. Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi, kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës (N. 62, i KZ).

KShH ka konstatuar se, në institucione të posaçme si spitalet rajonale në Shkodër, Vlorë, Korçë, Fier, Kukës, Gjirokastrë etj. nuk janë ngritur qendra votimi, megjithëse plotësonin kushtet ligjore. Pranë tyre trajtoheshin me dhjetëra pacientë, të shtruar prej më shumë se tre ditë.

Ndryshe ka ndodhur me institucionet e burgimit dhe paraburgimit ku u hapën QV. Një pjesë e personave me liri të kufizuar që ishin të sistemuar në këto institucione u regjistruan në listat e zgjedhësve për të votuar në institucion dhe për shumë të tjerë ushtrimi i të drejtës së votës u realizua nëpërmjet vendimeve gjyqësore, ndonëse në disa raste në kundërshtim me ligjin. (*për më tepër shih kreun IV. Listat e zgjedhësve dhe X, Gjykatat*)

h) Përfundimi i procesit të votimit

Përfundimi i procesit zgjedhor përgjithësisht është kryer në orën dhe mënyrën e parashikuar në ligj. Kodi Zgjedhor parashikon se, QV mbyllet pasi ka votuar zgjedhësi i fundit i pranishëm në QV në orën 1900. Megjithatë, pati dhe raste të veçanta shkeljeje të ligjit si ai i QV nr. 1709 Tiranë, e vendosur pranë shkollës “Mihal Grameno” (KZAZ nr. 32), ku QV u mbyll në 19.03, sepse nuk kishte më zgjedhës për të votuar dhe u rihap në orën 19.10 për të mundësuar votimin e dy zgjedhësve që mbërritën në QV në atë kohë.

IX. Proçesi i numërimit

a) Shoqërimi i materialeve dhe kutive të votave

Shoqërimi i kutive me dokumentacionin e QV është kryer përgjithësisht në rregull dhe proçesi i numërimit nuk ka filluar derisa është përfunduar dorëzimi i bazës materiale nga të gjitha KQV-të.

Pas mbylljes së qendrave të votimit, KQV-të kanë shoqëruar materialet e votimit dhe kutitë e votimit në KZAZ-të përkatëse, ku do të kryhej numërimi i votave. Kutitë e para kanë mbërritur në KZAZ-të përkatëse duke filluar nga ora 20.00 e datës 21 Qershor 2015 dhe ky proçes është mbyllur përgjithësisht në orët e para të ditës tjetër. Disa QV me vendndodhje larg vendit të dislokimit të QNV-së përkatëse, si dhe për shkak të pritjes në radhë për dorëzimin e materialeve, kanë përfunduar dorëzimin me vonesë, si p.sh KZAZ nr. 47, Bashkia Elbasan. Nuk është raportuar asnjë rast për dëmtim të materialeve zgjedhore gjatë transportit, në zonat ku kanë qenë prezent vëzhguesit tanë, ndërkohë që ishin marrë masa të mira për pritjen dhe marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore pranë KZAZ-ve.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

b) Ngritja e komisioneve të numërimit të votave

Pas marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore, nga KZAZ-të filloi trajnimi i anëtarëve të KNV-ve nga ekspertët të KQZ-së dhe më pas është vijuar me fillimin e numërimit të votave.

c) Zbatimi i orarit për fillimin e numërimit

Në përgjithësi, procesi i numërimit të votave është zhvilluar pa shkelje si dhe për një kohë më të shkurtër se në zgjedhjet e mëparshme. Në pjesën më të madhe të KZAZ-ve të monitoruara, procesi i numërimit ka filluar në orët e para të mëngjesit të datës 22 Qershor 2015, si në Korçë (KZAZ nr. 72), në Kukës (KZAZ nr. 11), në Elbasan (KZAZ nr. 47), etj për shkak të mos-emërimit të numëruesve si dhe për shkak të trajnimit të tyre me vonesë. Kështu në KZAZ nr. 84, Bashkia Vlorë numërimi nuk ka filluar në kohën e duhur pasi një subjekt politik nuk kishte dërguar listën emërore të numëruesve të saj. Një arsye tjetër e mosfillimit të numërimit ishte edhe mosparaqitja në kohë e anëtarëve të GNV-ve, ndërsa u konstatua se anëtarët e GNV-ve, në KZAZ nr. 4, Bashkia Shkodër, nuk janë trajnuar nga ekspertët e KQZ. Po kështu në KZAZ nr. 2 (Bashkia Shkodër) numërimi ka filluar në mesditën e dt. 22.06.2015.

d) Ecuria e numërimit

Në përgjithësi, konstatohet se procesi i numërimit ka vazhduar tej afatit ligjor, duke shkaktuar një zgjatje të procesit të numërimit, ndonëse ky proces ka ecur më shpejt se në zgjedhjet e kaluara. Në shumë raste procesi i numërimit është ndërprerë herë pas here, pasi anëtarët e GNV-ve kanë kërkuar kohë pushimi për t'u shpłodhur, ose nevoja të tjera vetjake. Gjithashtu në disa QNV, si ato të Shkodrës, numërimi është ndërprerë disa herë, duke rifilluar me kalimin e kohës për shkaqe të panjohura.

Të pranishëm në ambientet e numërimit kanë qenë persona të akredituar, vëzhgues vendas apo të huaj, përfaqësues të medias dhe në ndonjë rast, kandidatë dhe përfaqësues të partive politike. Jashtë ambienteve ka patur prezencë të madhe të mbështetësve të kandidatëve apo subjekteve të caktuara politike.

KShH vëzhgoi përmes një numri të kufizuar vëzhguesish edhe procesin e numërimit të votave, proces i cili përgjithësisht u zhvillua duke respektuar procedurat e parashikuara në KZ dhe pa shkelje të tjera. Vëzhguesit e KSHH-së nuk janë penguar për të hyrë dhe për të monitoruar procesin e numërimit. Një shkelje tjetër e konstatuar nga vëzhguesit tanë ishte dhe se vëzhguesit e kandidatit të pavarur për kryetar Bashkie në Vlorë dhe tre vëzhgues të disa partive të vogla, janë penguar të hyjnë dhe të kryejnë detyrën në KZAZ nr. 83, ku kryhej procesi i numërimit të votave, ndërkohë që vëzhguesit e forcave të mëdha politike ishin pranuar. Një veprim i tillë jo vetëm vjen ndesh me ligjin dhe të drejtat e kandidatëve që marrin pjesë në konkurim, por shkakton dhe trajtim diskriminues midis vëzhguesve dhe kandidatëve që ata përfaqësojnë.

X. Vëzhguesit e procesit dhe vërejtjet me shkrim të tyre



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Vëzhguesit ndërkombëtare dhe kombëtarë, midis tyre dhe ata të KShH-së kanë ushtruar të drejtën e tyre ligjore për të monitoruar procesin parazgjedhor, zgjedhor dhe atë të numërimit të votave, duke përfshirë dhe veprimtarinë e organeve të administrimit zgjedhor. **Sipas rastit ata kanë komunikuar ose kanë paraqitur vërejtje me shkrim** pranë KQZ, KZAZ-ve ose KQV-ve për shkeljet e konstatuara. Vëzhguesit e KSHH kanë bërë më shumë se 52 vërejtje me shkrim, pranë KQV-ve, prej të cilave shumica janë pranuar e protokolluar, ndërsa 14 jo. Vërejtjet lidhen me shkelje si: lejimi e votimit familjar; me qëndrimin e anëtarëve të KQV-së pranë dhomës së fshehtë, ose komunikim me zgjedhësin që ndodhej në dhomën e fshehtë; me moskontrollin e duhur të timbrosjes së gishtave; me komunikim me zë të lartë të identitetit dhe numrit rendor të zgjedhësve që votonin, si dhe vërejtje të tjera që lidhen me shkeljet e parashtruara në këtë raport.

Për parregullësitë e konstatuara nga vëzhguesit KShH kanë vënë menjëherë në dijeni edhe KQZ, si organin më të lartë shtetëror për administrimin e zgjedhjeve, me qëllim marrjen e masave dhe parandalimin e përsëritjes së shkeljeve. Disa prej vërejtjeve të KShH-së janë mirëpritur nga KQV-të, shkeljet janë korigjuar menjëherë si dhe vërejtjet janë protokolluar si p.sh. në QV nr 1699, 1703, 1699/1-(3 raste), 1703- (3 raste), 1703/1- (2 raste), 1699/2-(2 raste), 1699 – (2 raste), 1709, 1715, 1767- (2 raste), 1741/1- (3 raste), 1740/1, 1694/1, 1691, 1980, 3023, 3177, etj.

Përgjithësisht vëzhguesit janë mirëpritur dhe ndihmuar për të kryer detyrën e tyre, por nuk kanë munguar dhe raste sporadike kur atyre u janë shkaktuar pengesa për të marrë pjesë në procese të caktuara të procesit zgjedhor, si hapja e QV-ve.

XI. Performanca e Gjykatave, Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit

a) Gjykatat

Është rritur numri i kërkesave drejtuar Gjykatave të Rretheve Gjyqësore për të kërkuar ushtrimin e të drejtës së votës dhe organet gjyqësore e përballuan këtë fluks me sukses. Megjithatë, konstatohet se shumica e kërkesave janë paraqitur nga persona me liri të kufizuar (të paraburgosur osë të dënuar). Gjykatat kanë marrë masa për të pranuar dhe gjykuar në afat kërkesat, por masat e organizimit kanë qenë të pamjaftueshme në lidhje me njoftimet e kërkesave për orarin e zhvillimit të seancave gjyqësore. Shumica e kërkesave janë paraqitur në gjykatat 1-2 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe formulimi i kërkesave nuk përmbante mjete komunikimi të shpejta si, telefon, telefon mobil, email, ndërsa sekretaritet e gjykatave nuk e plotësuan këtë mangësi në momentin e pranimit të kërkesave. Kjo i vendosi gjykatat në pozita pritëse për të filluar gjykimin e kërkesave, në momentet kur kërkuar paraqitej me iniciativën e vet. Mjetet e zakonshme të njoftimit të palëve në këtë rast nuk mund të ishin efektive, për shkak të kohës së shkurtër që gjykatat kanë në dispozicion për shqyrtimin e këtyre kërkesave. Ndryshe nga zgjedhjet e kaluara jo të gjitha gjykatat përgatitën dhe vunë në dispozicion të kërkesave formularë të gatshëm kërkesë, të cilat janë më të plota dhe me të dhënat e nevojshme për kërkimin e ushtrimin të të drejtës së votës.

Bie në sy se shumica e kërkesave të paraqitura nga shtetas me të drejtë vote janë pushuar, ndërsa kërkesat e të dënuarve dhe paraburgosurve janë pranuar. Gjykatat kanë pranuar për shqyrtim kërkesa nga shumë institucione paraburgimi e burgimi të vendit si: 388 kërkesa në



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, 290 kërkesa në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, 518 kërkesa në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, 46 kërkesa në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, 73 kërkesa në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Fier, etj.

Shumë vendime gjyqësore janë pasqyruar në databazën elektronike të gjykatave të paarsyetuara. Duke lexuar disa nga vendimet e arsyetuara të bëra publike konstatuam hetim të cekët gjyqësor rreth kërkesave, moskonsultim të listës përfundimtare të zgjedhësve. U konstatua se në disa raste pranimi i kërkesave është bërë në kundërshtim të hapur me ligjin, konkretisht me Pikën 2, të Nenit 57 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet se, “**nëse zgjedhësi ndryshon vendbanimin pas shpalljes së listës përfundimtare të zgjedhësve dhe kërkon gjyqësisht të autorizohet të votojë në vendbanimin e ri, kërkesa e tij rrëzohet.**” Kjo ka ndodhur kryesisht me kërkesat e paraqitura nga institucionet e burgimit dhe parburgimit.

Gjithashtu, KShH ka konstatuar publikimin me vonesë të Vendimeve të Kolegjit Zgjedhor në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Tiranë, gjë për të cilën kemi ndërhyrë duke kërkuar zyrtarisht botimin e rregullt të këtyre vendimeve, në përputhje me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR.⁷

b) Policia e Shtetit

KShH ka konstatuar se Policia e Shtetit, përgjithësisht, ka kryer detyrën me profesionalizëm dhe paanshmëri. Ajo ka qenë në gatishmëri për ruajtjen e rregullit dhe rendit, duke mbikqyruar QV dhe selitë e organeve të tjera të administrimit zgjedhor, si dhe ecurinë e procesit zgjedhor, në distancën e duhur dhe me korrektësi. Megjithatë mbetet vërejtja që, për shkak të mungesës së parashikimeve në KZ dhe të mënyrës së organizimit të punës së organeve të policisë, **nuk u mundësua ushtrimi i të drejtës së votës nga një numër i lartë i punonjësve të këtij shërbimi.** Ata filluan shërbimin përpara hapjes së QV-ve dhe e lanë atë pas mbylljes së tyre, ndërsa shumë prej tyre u dërguan me shërbim jashtë vendbanimit të tyre dhe ligji nuk parashikon mundësinë e votimit në QV të tjera.

c) Prokuroria

Organi i Prokurorisë nuk lidhet direkt me veprimtarinë zgjedhore, përveç kur gjatë këtij procesi manifestohen shkelje ligjore që përbëjnë veprë penale. Megjithatë mendojmë se ky organ duhej të kishte vepruar me shpejt për ndjekjen e shqyrtimin e kallzimeve penale të bëra gjatë kësaj periudhe, në të cilat ngriheshin pretendime për shkelje të ligjit dhe vepra penale lidhur me procesin zgjedhor, si dhe për verifikimin e vërtetësisë dhe shkallës së inkriminimit të kandidatëve për kryetarë bashkie e këshillat bashkiake.

XII. Sjellja e subjekteve zgjedhore

Subjektet zgjedhore dhanë kontributin e tyre në ruajtjen e qetësisë dhe zhvillimin e zgjedhjeve të qeta. Ata zhvilluan një fushatë zgjedhore më të qetë se në zgjedhjet e mëparshme. Në daljet në publik, liderët e partive kryesore politike kanë bërë thirrje që votuesve të shkojnë për të votuar, si dhe kanë shpjeguar rëndësinë e këtyre zgjedhjeve. Megjithatë nuk mungoi gjuha e ashpër dhe provokative ndaj konkurrentëve të tjerë. Në disa raste, përfaqësuesit e tyre trasmetuan tension nëpërmjet gjuhës së përdorur dhe me ndonjë

⁷ Shkresë e KShH nr. 184, dt. 12.06.2015, drejtuar Gjykatës së Apelit, Tiranë



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

sjellje jo korrekte e jo në përputhje me standardet e zgjedhjeve të lira e të drejta. Subjektet zgjedhore politike janë përgjegjësit kryesorë për mospastrimin e listave të kandidatëve të tyre nga personat e inkriminuar, prania e të cilëve është pohuar nga organizmat ndërkombëtare, Prokurori i Përgjithshëm dhe media investigative.

Përgjithësisht, heshtja zgjedhore është respektuar nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët, por pati edhe raste të izoluar të shkeljes së saj nga kandidatë të caktuar.

Subjektet zgjedhore kishin mobilizuar dhe dërguar pranë QV-ve vëzhgues dhe militantë të shumtë duke krijuar konfuzion dhe shqetësim tek zgjedhësit (QV nr. 1615, 1615/1, 1615/2, 1615/3 dhe 1615/4 etj). Në raste të rralla, në mjediset e QV-ve, u vunë re kandidatë, ose funksionarë të forcave politike, që vepronin pranë ose brenda QV-ve, pa qenë të ngarkuar për të kryer funksione në administratën zgjedhore. Shtetas të ndryshëm referuan pranë organizatave të shoqërisë civile pretendime në lidhje ushtrimin e presionit mbi ta, prej forcave të ndryshme politike ose drejtues të administratës vendore e qendrore, por këto pretendime nuk iu përcollën në asnjë rast organeve të ndjekjes penale.

XIII. Sjellja e shtetasve dhe mediave

Sjellja e zgjedhësve ishte më e mira, midis subjekteve të përfshirë në procesin e këtyre zgjedhjeve. Ata votuan me qetësi dhe korrektësi, duke shmangur, përgjithësisht, provokimet, tundimet ose shqetësimet e subjekteve ose administratës zgjedhore. Janë konstatuar sjellje sporadike, jo ligjore të votuesve, si rasti i votuesit në QV nr. 1757, që tentoi të marrë me vete fletën e votimit, ose sjellja e disa votuesve që kanë fotografuar votën e tyre, madje i kanë postuar ato dhe në mediat elektronike (ne QV nr. 1728, Tiranë, etj).

Megjithëse pati pretendime për tentativa dhe fakte të blerjes së votës, të parashtruara nga subjektet zgjedhore të të dyja koalicioneve të mëdha, KShH nuk konstatoi në mënyrë të drejtëpërdrejt, fakte të tilla. Për shkak se fenomeni është një shkelje e rëndë e lirisë së votës dhe një fenomen i pretenduar shpesh edhe në zgjedhjet e kaluara, organet e drejtësisë duhet të kishin vepruar më mirë për të vërtetuar, ose rrëzuar dyshimet e hedhura, me qëllim që t'i pritët rruga sjelljeve të tilla në të ardhmen.

Mediat pasqyruan gjerë procesin zgjedhor, por pati dhe shkelje të kohës së vënë në dispozicion për subjektet zgjedhore të vogla ose kandidatët e pavarur. Mbeti problem i pazgjidhur për mediat pasqyrimi i fushatave të partive të mëdha politike nëpërmjet materialeve të përgatitura nga vetë subjektet zgjedhore. Disa media investigative u përpoqën të hedhin dritë mbi kandidatët e inkriminuar dhe i dhanë publikut të vetmin informacion të pakët në këtë drejtim.

XIV. Konkluzione dhe rekomandime

Meqënëse për shkak të mungesës së financimit të mjaftueshëm, shtrirja e monitorimit të këtyre zgjedhjeve nga KSHH ka qënë relativisht e kufizuar, **konkluzionet tona jepen mbi bazën e informacionit që kemi marrë në mënyrë të drejtëpërdrejt**. Megjithatë, mendojmë se lidhur me cilësinë e **zgjedhjeve të 21 Qershorit 2015, mund të thuhet se në këto zgjedhje është hedhur një hap përpara në plotësimin e standardeve të**



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Kopenhagenit, gjë që na lejon të vlerësojmë se këto zgjedhje, të paktën në disa drejtime, mund të cilësohen më të mira se zgjedhjet e mëparshme. Përmirësimet u vërejtën në këto drejtime:

- **Zgjedhjet shënuan standarde më të mira përsa i përket lirisë së votës, duke krijuar mundësi më të mira për shtetasit që të ushtronin të drejtën e votës,**
- **Zgjedhjet plotësuan, përgjithësisht, standardin e fshehtësisë së votës, si dhe të barazisë së zgjedhësve dhe votës së tyre.**
- **Subjekteve zgjedhore iu dha mundësia të prezantojnë, pa diskriminim, listat me kandidatët e tyre dhe të zhvillojnë fushatë në mbështetje të tyre, duke shprehur lirisht opinionet dhe programet e tyre, por mbetet e nevojshme përmirësimi i legjislacionit, me qëllim që t'u ofrohen mundësi të barabarta edhe kandidatëve të pavarur.**
- **Zgjedhësit treguan se kanë rritur kuptimin e tyre rreth rolit që kanë në procesin e votimit, ata u paraqitën më të ndërgjegjësuar për ushtrimin e lirë të së drejtës për të votuar.** Pjesëmarrja në votime ishte e mirë, po të mbahet parasysh se më shumë se 1 milion zgjedhës jetojnë jashtë vendit.
- **Zgjedhësit ishin më të gatshëm për të deklaruar presionin e bërë mbi ta, me qëllim manipulimin apo blerjen e votës, ndonëse këto deklarime mbetën në nivelin e pretendimeve dhe nuk u denoncuan pranë organeve kompetente.**
- **Shumë prej kandidatëve manifestuan sjellje korrekte dhe të qetë gjatë fushatës, duke u distancuar nga gjuha agresive dhe fyese që përdorën nganjëherë, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore që i kishin përfshirë në listat e tyre.**
- **Gjuha e komunikimit e përfaqësuesve të forcave politike ishte disi më e qetë se në zgjedhjet e mëparshme dhe për pasojë nuk u shënuan raste incidentesh të rënda midis militantëve.**
- **Listat e zgjedhësve shënuan përmirësim të mëtejshëm.**
- **Prezenca e vëzhguesve, vendas dhe të huaj në QV u mirëprit, në përgjithësi, dhe ata nuk u penguan për të kryer detyrën e tyre.**
- **Policia e shtetit vazhdoi të kryej detyrën e vet me profesionalizëm edhe në këto zgjedhje.**
- **Si rezultat i vendosjes së kuotës gjinore në KZ u rrit ndjeshëm pjesëmarrja e grave në organet e pushtetit vendor që dolën nga këto zgjedhje, por duhet bërë më tepër kujdes për përfaqësimin e pakicave në listat e kandidatëve.**

Me gjithë rezultatet e mësipërme, gjatë këtyre zgjedhjeve u evidentuan dhe një sërë problematikash, një pjesë e të cilave janë manifestuar edhe në zgjedhjet e mëparshme:

- **Ndyshimet në KZ nuk u bënë sipas nevojave të evidentuara** dhe sugjerimeve të bëra nga OSBE/ODIHR, ose vëzhguesit vendas. Amendimet e pakta u realizuan jo vetëm me vonesë, por pa transparencën e duhur dhe përfshirjen e publikut.
- **Legjislacioni zgjedhor përmban disa probleme që duhen përmirësuar si:** kufizime në adresë të kandidatëve të pavarur, duke krijuar dallime, ose kushte shtesë për ta, të cilat nuk ekzistojnë për kandidatët e subjekteve politike; KZ nuk shprehet qartë në lidhje me kufizimet e mundshme për ushtrimin e të drejtës së votës në zgjedhjet për organet e pushtetit vendor, siç është shprehur me vendimin e saj nr. 40 dt.16.11.2007 Gjykata Kushtetuese; ligji nuk parashikon garancitë e duhura me qëllim që zgjedhësit të kenë mundësi të informohen për cilësitë e kandidatëve, veçanërisht për kandidatët për këshilltarë; etj.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- Administrimi zgjedhor, megjithëse në një masë më të reduktuar, tregoi përsëri se caktimi i anëtarëve të organeve të administrimit të zgjedhjeve vetëm nga partitë politike parlamentare, passjell ndikimin partiak të tyre, njëanshmëri dhe mosbatim rigoroz të ligjit. Kjo formë përzgjedhëse e anëtarëve të organeve të administratës zgjedhore mohon të drejtën e zgjedhësve, si aktorët kryesorë të procesit zgjedhor për t'u përfaqësuar në këto organe.
- Trasparenca e veprimtarisë së KZAZ-ve lë ende për të dëshiruar, sepse nuk ka parashikime të qarta ligjore për detyrimin e këtyre organeve për të bërë publike veprimtarinë e tyre dhe për të mundësuar pjesëmarrjen publike gjatë vendim-marrjes së tyre.
- Nuk u bë sa duhet nga administrata zgjedhore dhe subjektete zgjedhore, që t'u ofrohej informacion i plotë zgjedhësve lidhur me cilësitë e kandidatëve që konkurronin për postet e kryetarëve të bashkive dhe për këshilltarë të këshillave bashkiake. **Pretendimet për kriminalizimin e një pjese të kandidatëve nuk u sqarua dhe për pasojë zgjedhësve nuk ju dha mundësia të marrin informacionin e duhur në këtë drejtim.**
- Ka ende probleme në unifikimin e praktikës gjyqësore në lidhje me shqyrtimin e çështjeve me objekt të drejtën e votimit dhe çështje të tjera që përfshihen në procesin zgjedhor. Vendimet e gjykatave nuk bëhen gjithmonë publike të arsyetuara.
- Në ndonjë rast ka probleme me cilësinë e materialeve zgjedhore që u vihen në dispozicion QV-ve ditën e votimit.
- Mbeten të pazgjidhura disa probleme lidhur me votimin e zgjedhësve që banojnë jashtë shtetit, i punonjësve që kryejnë detyra të posaçme, larg vendbanimit, gjatë ditës së votimit (si policia e shtetit etj.), i personave me aftësi të kufizuar dhe personave të shtruar në institucionet shëndetësore.
- Rezultatet e Zgjedhjeve Vendore edhe në këtë rast u shpallën me vonesë, sepse shqyrtimi i ankesave të subjekteve zgjedhore, drejtuar KQZ dhe Kolegjit Zgjedhor, u shqyrtuan për një kohë të gjatë.
- Donatorët vendas dhe të huaj, me përjashtim të Departamentit Amerikan të Shtetit, nuk mbështetën sa duhet monitoruesit e pavarur brenda vendit.

Sugjerime

1. Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore, pranë Kuvendit, të ngrihet sa më parë, mundësisht që në muajin Shtator 2015 dhe të fillojë të shqyrtojë rekomandimet e OSBE/ODIHR-it dhe të shoqërisë civile për përmirësimin e KZ dhe legjislacionit në përgjithësi, në drejtim të përmirësimit të garancive për ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur e për t'u zgjedhur, si dhe nevojat e tjera për përmirësimin e procesit zgjedhor.
2. Legjislacioni duhet të parashikojë garanci më të plota për të mos lejuar manipulimin e zgjedhësve, përdorimin e administratës dhe fondeve publike, të drejtën e vëzhguesve vendorë për të bërë vërejtje me shkrim edhe gjatë procesit të numërimit të votave, etj.
3. Është e nevojshme të shqyrtohet mundësia e depolitizimit të organeve të administrimit zgjedhor dhe për të përfshirë në to përfaqësuesit e zgjedhësve të paangazhuar politikisht.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

4. Sugjerojmë të rishqyrtohet mundësia e vënies në përdorim i sistemit elektronik të votimit, qoftë edhe në formë pilot, si dhe të shkurtohen afatet e shqyrtimit të ankesave nga KQZ dhe Kolegji Zgjedhor.
5. Është e domosdoshme të fillojë sa më parë, hartimi i projektligjit për referendumet, i cili sugjerojmë të jetë ligj më vete. Kjo dispozitë merr rëndësi të veçantë në kuadër të reformës së pushtetit vendor dhe demokratizimit të mëtejshëm të jetës së vendit dhe rritjes së pjesëmarrjes së shtetasve në qeverisjen e vendit. Komisioni i Venecias ka bërë vërejtje të rëndësishme në këtë drejtim që në vitin 2004.
Të unifikohet legjislacioni në lidhje me përcaktimin e vendbanimit të përhershëm dhe vendqëndrimit të shtetasve, me qëllim që përcaktimi i KZ *se përfshirja në listat e zgjedhësve të shtetasve me të drejtë vote bëhet në bazë të vendbanimit të tyre*, të mos ketë interpretime të ndryshme. Në këtë drejtim, sugjerojmë që në mbështetje të hierarkisë së normave të mbahen parasysh përcaktimet e Kodit Civil dhe interpretimi i Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 40, dt. 16.11. 2007.
6. KZ të parashikojë procedura të qarta dhe afate të sakta lidhur me zëvendësimin e kandidatëve të listave të mbyllura të subjekteve zgjedhorë, pasi ato janë depozituar pranë organeve të administrimit zgjedhor. Të saktësohet procedura për vet-tërheqjen e kandidatëve nga lista, si dhe të qartësohet ligjërisht nëse do të lejohet zëvendësimi i këtyre kandidatëve, si dhe afatet për këtë qëllim. Sugjerojmë që për kandidatët, që hiqen nga lista sepse rezultojnë të inkriminuar, subjekti zgjedhor të mos ketë të drejtë të kandidojë person tjetër në vend të tij.
7. Të shtohen garancitë ligjore për të parandaluar që subjektet zgjedhore të zhvillojnë fushatë zgjedhore përpara kohës së parashikuar në ligj.
8. Sugjerojmë që KZ të parashikojë kritere penguese për kandidimin e personave të inkriminuar, si dhe të përcaktojë më tepër garanci në këtë drejtim, duke përcaktuar dhe organe përgjegjëse për të bërë verifikimet e duhura, brenda afateve sa më të shpejta kohore, në këtë drejtim. Të garantohet transparenca e informacionit që do të përftohet në këtë drejtim.
9. Në KZ duhet sanksionuar më qartë e në mënyrë më të plotë e drejta e zgjedhësve për t'u njohur me kandidatët e përfshirë në listat e subjekteve zgjedhore dhe nga ana tjetër prezantimi i hollësishëm i kandidatëve duhet të parashikohet si detyrim për subjektet zgjedhore, ose duhet të parashikohen mundësi të tjera për të bërë publike cilësitë e kandidatëve dhe pastërtinë e tyre morale shoqërore. Fushata zgjedhore t'u ofrojë më shumë mundësi komunikimi zgjedhësve me kandidatët për deputetë ose për personat që konkurojnë për organet e pushtetit vendor.
10. Të rishikohet kapitulli i KZ që bën fjalë për përgatitjen, ndryshimin dhe publikimin e listave të zgjedhësve, për ta saktësuar atë dhe për ta përshtatur me organizimin e ri administrativo-territorial.
11. Sugjerojmë që, Bordi i Monitorimit të Medias të zgjidhej nga Unioni i Gazetarëve, ose forume të tjera të gazetarëve, duke respektuar disa kritere që do të garantonin profesionalizëm dhe paanësi politike, siç parashikon Neni 85/1 i Kodit Zgjedhor.
12. Sugjerojmë që të shikohet mundësia për të vendosur kufizime në KZ lidhur me rikandidimin, veçanërisht për postin e kryetarit të bashkisë, me qëllim



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- që të zgjerohet mundësia e zgjedhësve për të kandiduar për këtë post monokratik.
13. Përmirësime i duhen bërë KZ me qëllim që të mundësojë më mirë fuqizimin e rolit të zgjedhësit në procesin zgjedhor, duke u garantuar atyre më mirë përfshirjen në listat e zgjedhësve; njohjen me këto lista; mundësinë e komunikimit me administratën zgjedhore dhe për të kërkuar respektimin e të drejtës së votës, ose për garantimin e ushtrimit të të drejtës së votës për zgjedhësit me aftësi të kufizuar, veçanërisht të atyre që janë të shtruar në spitale, që jetojnë jashtë vendit, ose që për shkak të detyrës ditën e zgjedhjeve janë larg nga vendbanimi.
 14. Të shqyrtohet mundësia e votimit nga ana e shtetasve shqiptarë me të drejtë vote, që jetojnë në emigracion, duke përdorur format e njohura që janë aplikuar në vendet demokratike.
 15. KZ të përcaktojë në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe më të saktë funksionarët publikë që duhet të lenë detyrën kur kandidojnë për deputetë ose funksione të pushtetit vendor, si dhe mjetet për të garantuar dorëheqjen reale të tyre. (n.63/4).
 16. Legjislacioni zgjedhor duhet përmirësuar për të shmangur dallimet midis procedurave të kandidimit midis kandidatëve të përfshirë në listat e subjekteve zgjedhore dhe atyre të pavarur.
 17. Përmirësimi i legjislacionit zgjedhor të kryhet me procedurë transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë në të forcat politike aktive dhe organizatat e shoqërisë civile të specializuara.
 18. T'i kushtohet më tepër rëndësi informimit dhe edukimit të zgjedhësve lidhur me të drejtën e votës.
 19. Vëzhguesve vendor dhe atyre të huaj t'u garantohet kohë falas në median publike për të informuar publikun për gjetjet e tyre të monitorimit, gjatë fushatës dhe pas përfundimit të zgjedhjeve.